

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7635 E mërkurë 29 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**
Marrëveshja e Kosovës me Malin Le Zi për demarkacionin, kaloi nëpër diskutime dhe tensione të mëdha publike e politike (pati zgjedhje të parakohshme)...
Vijon në faqen 20

Nga ARBEN ÇEJKU
Kush do ta pengojë ndarjen e Kosovës?



Opinion **Ditës**
Mbrëmë kanë biseduar për gjendjen politike në Ballkanin Perëndimor dhe për statusin final të Kosovës presidenti i Shteteve të Bashkuara të ...
Vijon në faqen 21

Nga BERAT BUZHALA
Kosova e pavarur, si u bë përsëri çështje e hapur?



Shantazh ndaj Ledi Biankut: Ngelesh pa punë

Biseda e përgjuar, kërkesë gjyqtares: Pronat, të bllokohen gjyqet e Strasburgut

Denar Biba: S'i bëra presion, e kam mik. Prokuroria nis hetimet. Basha: Akt mafioz

VALENTINA MADANI

Një audio-përgjim ku pretendohet se nënkryetari i KQZ-së, Denar Biba, i ka kërkuar në emër të qeverisë gjyqtarit shqiptar në Gjykatën e Strasburgut, Ledi Biankut, që të ndikojë pranë kësaj gjykate në lidhje me çështjet ...

Në faqen 3

EMRAT/ MINISTRIA E FINANCEVE PUBLIKON LISTEN E RE TE PERFITUESVE

1 MIJE TE PERNDJEKURIT QE MARRIN DEMSHPERBLIMIN

Trashëgimtarët që përfitojnë këstin e parë dhe të dytë. Kush e ka emrin në listë, duhet të dorëzojë numrin e llogarisë bankare brenda shtatorit



(Në foto) Ish-të përndjekur

SHTYHET EKSTRADIMI

Kokaina e kapur në Durrës, Arbër Çekaj hetohet edhe në Gjermani

Në faqen 7

PRIORITETET

Raporti i KE: 38% e shqiptarëve nuk ushqehen që të kursejnë më shumë

Në faqen 5

SHKODER

Vrau komshiu në thikë se e denoncoi për vjedhje, pranga 33-vjeçarit

Në faqen 6

"SUMMER PAGES"

Klaudia Hajdari: Përfjetimet e mia si kandidate për komunën në Belgjikë

Suplenent

KANCELARJA GJERMANE



Kufiri Kosovë-Serbi, Merkel përsërit: Do të ketë pasojë në gjithë Ballkanin

Në faqen 17

Kush do të vazhdojë studimet te Stomatologjia, Farmacia dhe Fizioterapia

Shpallen fituesit në Universitetin e Mjekësisë

Renditja, pas raundit të parë. Procedura, kur do të bëhet regjistrimi

Nga VOLTIZA DURO

Të gjithë maturantët që kanë aplikuar në një prej 12 programeve të studimit në Universitetin e Mjekësisë mund të njihen me renditjen gjatë raundit të parë të aplikimeve. "Gazeta Shqiptare" pub-



likon sot emrat e 1040 fituesve në këto degë, ku secili mund të verifikojë nëpërmjet ID përkatëse, numrin e pikëve të grumbulluara që ndryshojnë nga njëri program studimi në tjetrin, në bazë të kriterëve të përcaktuara. Respektivisht ...

Në faqen 10-11

AUDIO-REGJISTRIMI REAGIMET

Audio-regjistrimi i Bibës, kreu i PD-së akuzo Ramës: Kërkon të shmangësh dëmshpërblimin e pronarëve

Shantazhi ndaj gjyqtarit në Strasburg, Basha: Akt mafioz

"Agaçi dhe Biba t'i dorëzohen drejtësisë"

Valentina Madani

Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha e cilësoi dje "skandal të përmasave europiane" shantazhin e bërë nga Denar Biba kundrejt gjyqtarit Ledi Bianku në Strasburg për çështjen e pronave. Sipas Bashës, është më se e qartë që qeveria e Ramës tashmë funksionon si grup mafioz. Z.Basha iu referua një audio-përgjimi të publikuar në media, për të akuzuar kryeministrin Edi Rama, se nëpërmjet sekretarit të tij të përgjithshëm Engjëll Agaçi dhe nënkryetarit të KQZ-së Denar Biba, shantazhohet gjyqtarin shqiptar të Gjykatës së Strasburgut "për të bllokuar vendimet e Strasburgut për pronat". "Një audio regjistrim ku dëgjohet shkoqur sesi gjyqtari shqiptar në Strasburg, Ledi Bianku, shantazhohet në emër të Engjëll Agaçit, sekretarit të përgjithshëm të kryeministrit dhe krahut të djathtë të Edi Ramës, që të ndikojë vendimet e pronave në favor të qeverisë, është prova më tronditëse në këto 28 vjet, që e faktin qeverinë e Edi Ramës si një organizatë tipike mafioze", deklaroi kreu i PD-së. Sipas tij ky shantazh është një akt i mirëfilltë mafioz, duke i kërkuar prokurorisë nisjen e hetimeve. "Kërcënimi është i qartë: Nëse nuk zbaton porosinë e Edi Ramës "pas përfundimit të mandatit do të mбетet pa punë dhe se sakrificat për të zbatuar me korrektësi ligjin nuk do t'i shërbejë për asgjë. Me këtë gjuhë tipike mafioze, i dërguari i Engjëll Agaçit, pra i Edi Ramës, i kujton gjyqtarit shqiptar në Strasburg se: "ky tren, pra mundësia e për të bërë pazar me qeverinë, nuk do t'i vijë më në jetë", u shpreh kreu i PD-së. Z.Basha akuzoi se drejtësia nuk është vegël e Ramës. Ky është një rast i paprecedent. Prokuroria duhet ta kishte ndjekur këtë mëngjes procedimin penal ndaj tyre për të treguar që drejtësia nuk është vegël e Ramës. Por prokuroria e kapur hesht siç ka bërë për çdo krim. Ky shantazh është një akt i mirëfilltë mafioz



Kryetari i PD-së Lulzim Basha

dhe një rast i paprecedent jo vetëm në historinë e shtetit shqiptar, por edhe i paimagjieshëm në historinë e Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut, theksoi z.Basha. Teksa kërkoj shkakimin e Denar Bibës dhe Engjëll Agaçit, Basha tha se kjo është prova dhe arsyeja pse komisioni i vettingut ka konfirmuar në detyrë gjyqtarë dhe prokurorë të korruptuar. "Engjëll Agaçi dhe Denar Biba, në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe me porosi të Edi

Ramës, kanë kryer veprat penale të korrupsionit aktiv dhe ushtrimit të ndikimit të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike. Prokuroria duhet të kishte nisur këtë mëngjes procedimin penal ndaj tyre, dhe duhet ta kishte komunikuar këtë publikisht, për të treguar se nuk është një vegël në dorën e Edi Ramës dhe të sejmëve të tij. Por prokuroria e kapur nga Edi Rama hesht, siç ka hesh-

LULZIM BASHA

AKUZA

"Sipas regjistrimit audio të publikuar nga media, Denar Biba, në emër të Engjëll Agaçit, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, ka shantazhuar gjyqtarin shqiptar në Strasburg, që të bëjë kompromis me Qeverinë në kurriz të të drejtave të pronarëve shqiptarë", tha z.Basha.



Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg

DEKLARATA

"Ky është një rast i paprecedent. Prokuroria duhet ta kishte ndjekur këtë mëngjes procedimin penal ndaj tyre për të treguar që drejtësia nuk është vegël e Ramës. Por prokuroria e kapur hesht, siç ka bërë për çdo krim,"-u shpreh kreu i PD-së.

"Aferë e ndyrë me përmasa gjigante"

Përgjimi, LSI: Qeveria tentoi të blejë Strasburgun, s'mund të falet

Kryetari i Grupit Parlamentar të LSI-së Petrit Vasili i kërkoi dje Prokurorisë të nisë sa më parë hetimet lidhur me publikimin e audio-përgjimit ku gjyqtari shqiptar i Gjykatës së Strasburgut Ledi Bianku shantazhohet duke i kërkuar të ndikojë në bllokimin e çështjeve të pronave. Bëhet fjalë për një bisedë me Denar Bibës, që atëherë mbante postin e zëvendës kryetarit të të KQZ-së, me gjyqtarin shqiptar të Gjykatës së Strasburgut Ledi Bianku, për t'i kërkuar atij të ndikonte tek kryetari i GJEDNJ-së për pezullimin e çështjeve të pronës të qytetarëve shqiptarë. Ai akuzoi se qeveria e drogës tentoi të blejë Strasburgun, me qëllim për të bllokuar fitimin e të drejtës nga ana e qytetarëve në lidhje me çështjet e pronave. Sipas Vasilit, prokuroria shqiptare duhet të fillojë hetimin e gjerë dhe të nxjerrë në shesh këtë aferë me përmasa gjigande. "Qeveria e drogës dhe e drejtësisë së horrave tentoi të blejë Strasburgun për të grabitur qytetarët shqiptarë. Kjo është vepra penale më e rëndë që mund të ketë konsumuar ndonjë qeveri ndonjë herë. Asgjë nuk mund të falet në këtë poshtërsi sh-tetërore. As prokuroria nuk do të falet, në qoftë se do të tentojë t'u shmangët përgjegjësive apo dhe të shmangët nga përgjegjësia qeverinë përpara kësaj afere gjigante në dëm të popullit shqiptar. Sot është dita ku asgjë mund të falet më, kurrë"- u shpreh z.Vasili.



"Rrezikon përjashtimin e Shqipërisë nga KE".

Audio-përgjimi, Berisha: Akt kriminal mafioz, Rama do marrë përgjigjen që meriton

Ish-kryeministri Sali Berisha e konsideroi dje një super skandal, daljen e një audio-përgjimi që implikonte qeverinë në një aferë të dyshimtë ku kërcënohej një gjyqtar i Strasburgut për çështjen e pronarëve shqiptarë. Të dashur miq, kryekumbar Noriega me sekretarin e përgjithshëm të mafies sh-tetërore don Agaçi, kërcënojnë haptas në mënyrën më kriminale në tempullin e drejtësisë të Europës, në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut, anëtarin e kësaj gjykate z.Ledio Bianku. Ata i kërkojnë gjykatës të ndikojë tek kryetari i kësaj



gjykate për të hedhur poshtë dhe mos shqyrtuar dosjet e dërguara nga pronarët legjitim të pronave të tyre të grabitura nga qeveria", tha z.Berisha. Sipas tij, ky akt kriminal mafioz i pashembullt dëshmon se mafia qeveritare shqiptare është një rrezik real serioz për institucionet europiane të drejtë-

sisë. "Ky akt ndërkombëtarisht i dënueshëm, që rrezikon përjashtimin e Shqipërisë nga Këshilli i Europës, dëshmon dhe një herë pse dërgohet për katër herë me radhë përfaqësuesi i familjes mafioze Xhafaj për t'u zgjedhur anëtar i Gjykatës së Strasburgut. Duke dënuar me ashpërsinë më të madhe këtë akt të shëmtuar të Noriegës, mafiozitet më të rrezikshëm të Europës, le të paralajmëroj me Ledi Ramën se për çdo cenim që mund t'i bëhet gjykatës në detyrën e tij do marrë përgjigjen që meriton",-shprehet z.Berisha.



Audio-përgjimi për bllokimin e gjyqeve të pronave, si u shantazhua gjyqtari shqiptar në Strasburg

Gjyqi i pronave, zbardhet biseda audio mes Bibës dhe Biankut

Ish-nënkryetari i KQZ flet "në emër të qeverisë"

Valentina Madani

Një audio-përgjim ku pretendohet se nënkryetari i KQZ-së, Denar Biba, i ka kërkuar në emër të qeverisë gjyqtarit shqiptar në Gjykatën e Strasburgut, Ledi Bianku, që të ndikojë pranë kësaj gjykate në lidhje me çështjet e pronave të qytetarëve shqiptarë. Kohë më parë qeveria shqiptare u përpoq të merrte një mirëkuptim nga Gjykata Europiane, për një stopim të proceseve gjyqësore në ngarkim të saj, nga individë të ndryshëm, derisa ajo të përpilonte një ligj të ri në lidhje me pronësinë. Exit.al ka siguruar një regjistrim të pjesshëm audio, i cili sipas tyre u dërgua në mënyrë anonime, përmes postës elektronike-të bisedës së zhvilluar mes Biankut dhe Bibës, e cila duket se është bërë në një mjedis publik, me gjasë bar ose kafe. Në audio-përgjimin e publikuar dëgjohet se si Denar Biba, pasi i bën ofertën Ledi Biankut, gjyqtarit tonë në Strasburg, duke e kërcënuar hapur: "A të ndalon më ky tren në stacion?! Të ngelesh pa punë dhe ç'të vajt sakrifica! Njeriu bën kompromise në jetë. Në regjistrim, Biba shprehet se atë e ka dërguar Engjëll Agaçi, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, për t'i kërkuar Biankut të ndihmojë qeverinë, duke nënkuptuar se ndihma do shpërblehet, kurse e kundërta do ta lërë Biankun pa hapësirë në sistemin e drejtësisë se vendit pas mbarimit të mandatit në Strasburg. Edhe pse regjistrimi ka shkëputje, në të dëgjohej qartësisht fjalët e Bibës: "Më mori Engjëll Agaçi, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, e më thotë ç'e ke Ledi Biankun? I thashë... Më thonë që nga gjithë këta që kemi afër ne ti e ke [më afër]. [Agaçi më] tha... hajde të pimë një kafe... ky muhabet të mërkurë, të enjte... Tha, kemi këto problemet, e di ti gjithë kjo historia që do kërkohet shtyrja. Të lutem tha, ti lutesh



Gjyqtari Ledi Bianku

BISEDA

Në audio-përgjimin e publikuar dëgjohet se si Denar Biba, pasi i bën ofertën Ledi Biankut, gjyqtarit tonë në Strasburg, e kërcënon hapur: "A të ndalon më ky tren në stacion?! Të ngelesh pa punë dhe ç'të vajt sakrifica! Njeriu bën kompromise në jetë"

TAULANT BALLA

Kreu i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla komentoi dje audio-përgjimin e publikuar në media ku ish-kreu i KQZ-së, Denar Biba i kërkonte favore gjyqtarit shqiptar në Strasburg, Ledi Bianku. Ai shprehet se të dy personazhet kanë detyrim publik për shpjegime. Balla tha se ka dyshime që biseda në fjalë të jetë përgjuar në shtëpinë e dy miqve.



"Metafora e trenit është ndryshe"

Denar Biba: Gjyqtarin Bianku e kam mik, nuk e kam shantazhuar

Denar Biba e pranon se në vitin 2014 në Strasburg është takuar me Ledi Biankun, gjyqtarin shqiptar të Gjykatës së Strasburgut. Por takim sipas tij ka qenë në rrethana krejtësisht miqësore, aspak shantazhues, siç deklaroi opozita duke iu referuar audio-përgjimit të publikuar për të cilin thotë se është i montuar. Biba sqaron se në Strasburg ishte si pjesë e delegacionit të qeverisë shqiptare dhe jo si nënkryetari i Komisionit të Zgjedhjeve, pasi në atë kohë sapo ishte emëruar në detyrën e Kryetarit të Prokurimeve Publike. Pikërisht për pranimin e këtij posti Biba është pyetur nga miku i tij Bianku, të cilit i ka dhënë këtë përgjigje. Pikërisht kjo fjalë nga opozita u cilësoi si shantazh që Biba i ka bërë anëtarit të gjykatës së Strasburgut. Nënkryetari aktual i KQZ shprehet se nuk i di arsyet e kësaj maskarade, siç e cilëson ai, dhe reagimit të kryetarit të opozitës në mbështetje të këtij audio-përgjimi. "S'ka nevojë të bëni dedektivim me mua. Unë e kam takuar mikun tim Ledi Bianku, ndër të tjera edhe në vizitën zyrtare pranë GJEDNJ, ku isha pjesë e delegacionit të kryesuar nga ish-zv kryeministri i kohës", -tha Biba.

BISEDA MES DENAR BIBËS DHE LEDIO BIANKUT

Denar Biba: Më mori Engjëll Agaçi, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, e më thotë ç'e ke Ledi Biankun? I thashë...

Më thonë që nga gjithë këta që kemi afër ne ti e ke [më afër].

[Agaçi më] tha... hajde të pimë një kafe... ky muhabet të mërkurë, të enjte...

Tha, kemi këto problemet, e di ti gjithë kjo historia që do kërkohet shtyrja.

Të lutem tha, ti lutesh të na gjendet në gjithë këtë histori... sot është Niko Peleshi [këtu në Strasburg] ka takim [me Kryetarin e GJEDNJ-së]

Denar Biba: Ma paguan ata biletën...

Pastaj, Biba i drejtohet Biankut për ta bindur që të pranojë të ndikojë:

"A të ndalon më ky tren në stacion? Të ngelesh pa punë dhe ç'të vajt sakrifica! Njeriu bën kompromise në jetë."

Prokuroria nis hetimet për audio-përgjimin Biba-Bianku

Prokuroria nis hetimet për përgjimin audio ku dëgjohet biseda mes Denar Bibës dhe gjyqtarit shqiptar të Gjykatës së Strasburgut Ledi Bianku. Exit.al, e cila publikoi audio-përgjimin duke pretenduar se nënkryetari i KQZ Denar Biba, në emër të sekretarit të përgjithshëm të kryeministrisë Engjëll Agaçi ka shantazhuar gjyqtarin përfaqësues të Shqipërisë në Gjykatën e Strasburgut, për të mbyllur problemin e pronave. Biseda është bërë në 2014. Vetë Biba pranoi se kishte bërë bisedën, por tha se e vërteta e metaforës së trenit nuk është ashtu, siç është interpretuar, si shantazh ndaj gjyqtarit që ky i fundit të bllokoi çështjet e pronave në Strasburg.

të na gjendet në gjithë këtë histori... sot është Niko Peleshi [këtu në Strasburg] ka takim [me Kryetarin e GJEDNJ-së]". Biba vazhdon: "Ma paguan ata biletën...". Pastaj, Biba i drejtohet Biankut për ta bindur që të pranojë të ndikojë: "A të ndalon më ky tren në stacion? Të ngelesh pa punë dhe ç'të vajt sakrifica! Njeriu bën kompromise në jetë". Exit.al kontaktoi me Ledi Biankun, i cili konfirmoi takimin me Bibën dhe në vija të përgjithshme përmbytjen e bisedës në regjistrimin audio, që na u dërgua në mënyrë anonime me postë elektronike. Bianku, gjithashtu, pohoi për Exit.al se në përputhje me detyrimet e tij etike dhe ligjore, pas takimit me Bibën, ai informoi në lidhje me këtë ndikim të papërshtatshëm Kryetarin e atëhershëm të GJEDNJ-së Dean Spielmann. Si asnjëherë më parë në historinë e Gjykatës së Strasburgut, lista e kandidatëve të dërguar nga qeveria shqiptare është refuzuar tri herë nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, e cila shqyrton tre kandidatët e paraqitur nga qeveria për të përzgjedhur njërin prej tyre. Afati i fundit i dorëzimit të listës së radhës-listës së katërt-ishte 31 gusht 2017, por qeveria e shpalli listën e aplikantëve vetëm para pak javësh dhe arriti ta dërgojë listën e katërt me tre kandidatët e përzgjedhur mes tyre në fund të korrikut 2018, thuasje një vit pas afatit të caktuar. Vlen të theksohet se asnjë nga kandidatët e paraqitur nuk i është nënshtruar vetingut, edhe pse reforma në drejtësi e ka bërë detyrimin kushtetues vetingun ndaj çdo kandidati për gjyqtar.

DREJTËSIA NGERÇI

Lista me emrat, Sollaku kërkon vendin e Fatos Lulos në Kushtetuese përballë Pandës

Gjykata Kushtetuese, Kuvendi shpall listën e kandidatëve

Aktualisht gjykata ka mbetur me 2 anëtarë

Valentina Madani

Kuvendi i Shqipërisë shpalli dje listën e kandidatëve për vendin e lënë bosh nga Fatos Lulo, i cili u shkarkua nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Emrat e kandidatëve që kanë paraqitur aplikimet janë publikuar në faqen e Kuvendit. Mes 7 emrave është edhe emri i ish-kryeprokurorit të përgjithshëm, i cili aktualisht ka pozicionin e avokatit të pavarur, Theodhori Sollaku. Ilir Panda ka qenë ish-ministër i Drejtësisë dhe ish-nënkryetar i KLD, aktualisht është pedagog i Magjistraturës dhe ekspert i nivelit të lartë në reformën në drejtësi. Sinan Tafaj vjen si përfaqësues i Shoqërisë Civile, (Shoqata e të verbërve). Valbona Bala ka qenë ish-këshilltare në Gjykatën Kushtetuese ndërsa Vasil Bendo është avokat. Elsa Toska është Pedagogë në Fakultetin Juridik. Fiona Papajorgji është këshilltare në Gjykatën Kushtetuese. Aktualisht Gjykata Kushtetuese ka mbetur me vetëm dy anëtarë, kryetari Bashkim Dedja dhe anëtarja Vitore Tusha që kanë kaluar vetëingun ndërsa tre anëtarët e tjerë që janë larguar të fundit nga detyra, janë Altina Xhoxhaj, Gani Dizdari e Fatmir Hoxha, të shkarkuar nga KPK dhe që presin vendimin përfundimtar për fatin e tyre, nga Kolegji i Posaçëm i Apelit. Dokumentacioni përkatës për secilin kandidat do t'i përcillet Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Më 17 korrik 2018 Kolegji i Posaçëm i Apelit i la në fuqi vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit i cili vendosi shkarkimin e tij. Gjyqtari Fatos Lulo nuk arriti të vërtetojë ligjshmërinë e një pasurie prej 48 milionë lekë. Konkretisht gjyqtari Lulo i nënshtroi skanimit të trefshët të vetingut për pastërtinë e figurës, aftësitë dhe pasuritë, por që me sa duket këto të fundit e nx-



Gjykata Kushtetuese

EMRAT

- 1 znj. Elsa Toska
2. znj. Fiona Papajorgji
3. z. Ilir Panda
4. z. Sinan Tafaj
5. z. Theodhori Sollaku
6. znj. Valbona Bala
7. z. Vasil Bendo

"Çdo tenderim abuziv, do ta çojmë para ligjit"

PD nxjerr dokumentet: Rama i jep 15 mln euro tenderë baxhanakut të tij

Deputetja e PD, Jorida Tabaku publikoi dje dokumente që, sipas saj, kryeministri për një periudhë 5-vjeçare i ka dhënë baxhanakut të tij tender 15 milionë euro. PD vijon me denoncimet me tenderët, që sipas selisë blu favorizohen njerëz të afërt me qeverinë. "Firma ABS që PD po denoncon, jo rastësisht është e lidhur me familjen e kryeministrit, ka mundur të përfitojë 15.6 milion euro tenderë nga shtatori 2013 deri më sot. Kompania "Advanced Business Solutions" zotërohet në bashkëpronësi nga baxhanaku i kryeministrit Armand Frangu, i cili së bashku me kompaninë B360 marrin pjesë gjithmonë në të njëjtët tenderë, gjithmonë duke ndarë përfitimet me njëri-tjetrin. Si rregull për ta bërë garën në dukje të ligjshme, por



nga ana tjetër është thjesht vetëm një farsë. Në tenderin e fundit të ofruar nga OSHEE me një vlerë prej 1.94 mld lekësh (të vjetër) kompania ABS ka pasur ofertën më të lartë dhe përsëri ka fituar", theksoi zj.Tabaku. Sipas saj kompania B360 shpik ka marrë pjesë në këtë tender si spektator. "Jo vetëm kaq, por Partia Demokratike këtu

publikon 41 tenderë që kompania ABS ka përfituar me vlerë 15.6 milionë euro nga shtatori 2013 deri më sot, si edhe 27 kontrata sekrete, të përfituara nga AKSHI me vlerë 850 mijë euro. Tenderi më i fundit i marrë nga kompania e tij nga AKSH-i, ka një vlerë prej 1.56 miliardë lekësh dhe përsëri ka fituar oferta më e lartë", u shpreh zj.Tabaku. Ajo denoncoi se "Vetëm për vitin 2017 sipas të dhënave publike të disponueshme online nga Agjencia e Prokurimit Publik, 1281 ose 26% të tenderëve të prokuruar, janë dhënë me ofertën më të lartë. Kjo i ka kushtuar buxhetit të shtetit 41 milionë euro, që mund të ishin përdorur për ndihmën ekonomike, që mund të ishin përdorur për mirëmbajtjen e të gjitha rrugëve në Shqipëri". Partia Demokratike angazhohet që çdo tenderim abuziv, ta çojë përpara ligjit.

orën atë jashtë drejtësisë. Një raport i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive konstatoi se Lulo kishte bërë deklaram të rremë të pasurisë. Aty evidentohen

dhuratat e të motrës prej 100 mijë eurosh në një rast, një zyrë avokatie, por edhe një borxh prej 480 mijë dollarësh kanadezë, imarrë prej saj për të blerë një banesë në

Kanada. Procesi i vetingut ka futur në kolaps edhe Gjykatën Kushtetuese, e cila nga mbetur me dy anëtarë, Bashkim Dedja dhe Vitore Tusha.



AMBASADA E SHBA

Ambasada amerikane bën thirrje publike për gjyqtarët e apelit në Shqipëri, që të aplikojnë për anëtar në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Duke iu referuar fakteve që deri më tani, nuk ka kandidat për këtë strukturë të rëndësishme, që do të ngrihet si pjesë e rëndësishme e reformës në drejtësi, Ambasada Amerikane ka publikuar thirrjen në faqen e saj zyrtare në Facebook.

TAKIMI

Ministria prezanton rezultatet e reformës në drejtësi

Gjonaj: Austria mbështetëse e Shqipërisë në zbatimin e reformave

Ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj takoi homologun e saj austriak Josef Moser, në Alpbach të Austrisë, i cili vlerësoi nisimat e Shqipërisë për reformimin e sistemit të drejtësisë dhe luftën kundër korrupsionit. Ai u shpreh që Austria do të jetë gjithmonë një partnere në krah të Shqipërisë për mbështetjen në zbatimin e reformave të ndërmarra nga Shqipëria. Moser shprehu mirënjohjen që për herë të parë ky event do të organizohet në Shqipëri duke promovuar vlerat dhe arritjet e mëdha që ka bërë deri tani Shqipëria si një vend evropian. Nga ana e saj, ministria Gjonaj, e njohu homologun austriak me rezultatet e para që reforma në drejtësi ka dhënë deri më tani duke njohur dhe të gjithë kontributin që kanë dhënë ekspertët austriakë në këtë proces si dhe mbështetjen politike të Komisionit Evropian. Në fund të takimit, ministri Moser shprehu gatishmërinë e tij dhe të ministrisë që ai drejton për të bashkëpunuar dhe asistuar Ministrinë e Drejtësisë në Shqipëri me çdo program mbështetjeje teknike për forcimin e kapaciteteve të ministrisë në reformat e ndërmarra.



Komisioneri për Mbrotjen e të Dhënave Personale kundërshton modelin e ri të aboneve të transportit urban, të cilat sipas një udhëzimi të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë përmbajnë edhe numrin e kartës së identitetit të qytetarit. Pas ankesave të kryera nga Qendra "Konsumatori Shqiptar", komisioneri



Debati për modelin e aboneve

Komisioneri kundër ID-së, Ministria e Infrastrukturës të marrë masa

ka konstatuar se vendosja e nr.ID është në kundërshtim me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave personale, si dhe përpunimi i tyre duhet të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu, i është kërkuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë marrja e masave në lidhje me përpunimin e të dhënave personale. Ndërkaq, vetë qytetarët shprehen se nuk janë da-

kord me formatin e ri të abonesë, por janë të detyruar të pranojnë pasi në të kundërt nuk mund të pajisen e për pasojë të mos udhëtojnë dot me urban. Ndryshimi i modelit të biletave aktu-

ale u bë përmes një udhëzimi të datës 9 maj 2018. Ndërkohë që, sipas modelit të ri të përcaktuar, numri ID do të vendoset poshtë fotografisë, që, gjithashtu, është e detyrueshme. Përveç këtij ndryshimi, udhëzimi përcaktonte edhe elementët e tjerë që duhet të përmbajnë abonët, duke përfshirë çmimin si dhe llojin e biletës së pajtimit mujor, që mund të jetë e përgjithshme, studenti apo emërtimi për linjën në të cilën ajo vlen.

Shqiptarët kanë përqindjen më të lartë në Europë për të mos shpenzuar për mish e perime


KE: 38 % e shqiptarëve zgjedhin të mos ushqehesh për të kursyer

Raporti: 46% e popullsisë blen më pak mish për të kursyer

Një ekonomi të kursyerit tek ushqimet. Megjithatë, për 38% e shqiptarëve të pyetur në anketën e cilësisë së jetës së Komisionit Europian, thanë se kanë blerë më pak fruta dhe perime për të kursyer para dhe 46% e tyre kishin blerë më pak mish nga se ju nevojitej për të njëjtën arsye. Përqindja e të anketuarve që iu janë përgjigjur me po pyetjes nëse kanë blerë më pak perime dhe fruta, por edhe mish, është më e larta në Shqipëri nga të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Europian, por edhe nga vendet kandidatë për t'u anëtarësuar. Në krahasim me vendet e rajonit, diferenca është e konsiderueshme. Pas Shqipërisë renditet Maqedonia, ku vetëm 28% e të anketuarve u përgjigjën se kanë blerë më pak perime dhe fruta që të kursejnë para, dhe 35% e tyre pohuan se kursyen tek racioni i mishit. Në Malin e Zi dhe në Serbi, përqindja e të anketuarve që thanë se kursyen tek blerja e frutave dhe perimeve është përkatësisht 15-16%.


VENDET E BE-SË

Ndër vendet anëtare të Bashkimit Europian, Suedia ka përqindjen më të ulët të anketuarve që kanë pohuar se kanë kursyer te fruta dhe perime për të kursyer, me vetëm 3%. Ndërsa më e larta ka qenë në Rumani, ku sipas Anketës së Cilësisë së Jetës, përqindja e të pyeturve që kanë kursyer te frutat dhe perimet është



29%. Përqindja e lartë Bullgari dhe Greqi, me përkatësisht 18 dhe 16%.

MË TË VARFRIT, TRYEZËN MË BOSH
Individët me të ardhura



të ulëta janë ata të cilët sakrifikojnë tek ushqimi. Sipas kategorive të të

ardhurave, përqindja e të anketuarve në Shqipëri që i përkisnin grupit të parë (të

ardhurat më të ulëta) dhe të cilët kishin kursyer te frutat dhe perimet ishte 60%, me e larta krahasuar për të njëjtin grup në të gjithë Europën. Në vendin fqinj, Malin e Zi, përqindja për këtë grup është vetëm 13%, në Turqi 33%, në Serbi 37% dhe në Maqedoni 46%. Anketa Europiane e Cilësisë së Jetës është një studim unik pan-europian që shqyrton kushtet e jetës së qytetarëve evropian në lidhje me mirëqenien individuale dhe cilësinë e shoqërisë dhe shërbimeve publike. Ai përfshin tema të tilla si shëndetësia, strehimi, ekuilibri i familjes dhe i punës dhe i jetës, si dhe besimi, pjesëmarrja në shoqëri, përjashtimi social dhe tensionet shoqërore.

FINANCAT

Aksioni i formalizimit, 20.9 mld lekë nga taksimi i pagave

Puna në të zezë dhe mos deklarimi real i pagave, duke privuar punonjësit nga përfitimet që vijnë përmes kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, është një problematikë e hershme e tregut të punës në vend. Së fundmi Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka identifikuar dy sektorët kryesorë ku abuzohet më shumë. Konkretisht bëhet fjalë për profesionet që ofrojnë shërbime në fushën e turizmit, si dhe në atë të Teknologjisë së Informacionit, të cilat janë vënë në qendër të vëmendjes nga administratat tatimore, për të deklaruar pagat reale. Ndërkaq, deklarimi real i pagave do të ndikojë

drejt përsëdrejti edhe në rritjen e të ardhurave në buxhetin e shtetit nga tatimi i të ardhurave personale, që për 7-mujorin e 2018-së janë realizuar në masën 56 për qind. Kështu, sipas treguesve fiskale të konsoliduar të Ministrisë së Financave, për periudhën janar-korrik 2018 janë mbledhur rreth 20.9 miliardë lekë vetëm nga taksimi i pagave të punonjësve, nga 37.3 miliardë lekë që është plani vjetor. Kështu në pjesën e mbetur të vitit, Ministria e Financave duhet të mbledhë edhe 16.4 miliardë lekë të tjera. Por me aksionin e fundit të administratës tatimore, e cila formalizoi rreth 2792 punonjës vetëm gjatë periudhës 28 maj -12 gusht 2018.

STUDIMI

Mikro-ekonomia shqiptare: Vetëm 0.1% e bizneseve janë të mëdha, 152 subjekte gjithsej

Bizneset e mëdha që kanë të punësuar më shumë 250 punonjës përbejnë vetëm 0.1 për qind të totalit të bizneseve, sipas të dhënave e një vrojtimit të bërë nga Banka Botërore të publikuar së fundmi, që i referohen vitit 2016. Vrojtimi numëroi gjithsej 108 mijë e 526 ndërmarrje aktive, nga të cilat sipas klasifikimit të Bankës Botërore, 102 mijë e 965 ndërmarrje ishin mikro duke zënë 94.9 për qind të totalit, biznese të vogla u numëruan 4413 ose 4 për qind e totalit, biznese të mesme ishin vetëm 996 subjekte, te cilat zunë vetëm 0.9% të totalit, teksa biznese të mëdha ishin

vetëm 152 subjekte ose 0.1% e totalit. Siç shihet ekonomia e vendit është e bazuar tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, por më së shumti tek mikro-ndërmarrjet. Në vitin 2016, sipas të dhënave kombëtare, 99.9 për qind e ndërmarrjeve aktive ishin të MSME-të, të cilat punësuan 81 për qind të numrit të përgjithshëm. Numri më i madh të këtyre subjekteve e zotërojnë tregtia (41.5%) dhe shërbimet (20 për qind). 67 për qind e vlerës së shtuar është realizuar nga SME-të. Përqindja më e lartë e vlerës së shtuar nga mikro-ndërmarrjet erdhi nga sektori i shërbimeve, strehimit dhe ushqimit. Sektori i tregtisë ka përqindjen më të lartë që dominohet nga bizneset e vogla,

ndërsa ndërmarrjet e mesme operojnë më së shumti në sektorin e industrisë për-punuese. Banka Botërore analizon se sektorët e ekonomisë të dominuar nga SME karakterizohen nga nivele të larta të informalitetit. Shumë MSME-të në Shqipëri veprojnë në baza jo-formale. Pavarësisht përmirësimeve të bëra kohë e fundit në luftën ndaj informalitetit, bizneset edhe pse janë regjistruar nuk deklarojnë xhiro dhe punonjësit dhe vijojnë të kryejnë transakcione në cash masivisht. Bizneset e paformalizuara në përgjithësi kanë produktivitet më të ulët se bizneset formale dhe u mungon mbrojtja sociale, sidomos sigurimet për punonjësit.

54-vjeçari Prendush Fusha u vra me thikë mbrëmjen e së hënës në afërsi të banesës

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Një ditë pas vrasjes së 54-vjeçarit Prendush Fusha në Shkodër, uniformat blu kanë lokalizuar dhe arrestuar autorin e dyshuar. Bëhet fjalë për 33-vjeçarin Alfred Pllumbaj, i cili dyshohet se pas një konfliktit për motive të dobëta ka goditur me thikë 54-vjeçarin duke e lënë të vdekur. Menjëherë pas vrasjes së ndodhur me dhjetëra forca policie janë vënë në ndjekje të 33-vjeçarit. Uniformat blu bëjnë me dije se fillimisht kanë bërë të mundur lokalizimin e autorit të dyshuar dhe më pas efektivet kanë ndërhyrë duke bërë kështu të mundur arrestimin e tij. 33-vjeçari është arrestuar mesditën e së martës në fshatin Bardhaj të njësisë Rrethina në Shkodër. Sipas burimeve Alfred Pllumbaj është larguar nga vendi i ngjarjes me një makinë ngjyrë jeshile. Sipas policisë kapja e autorit u bë e mundur si rezultat i rrethimit të zonës në një perimetër të gjerë nga efektivet.

"Lokalizohet, kapet dhe arrestohet autori i dyshuar i vrasjes së shtetasit Prendush Fusha, ndodhur mbrëmjen e së hënës rreth orës 19:15 në lagjen "Mark Lula". Pas një pune intensive të Forcave Operacionale në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, në bashkëpunim me FNSH Shkodër, u bë i mundur lokalizimi, kapja dhe arrestimi brenda 24 orëve, i shtetasit Alfred Pllumbaj, 33 vjeç, banues në lagjen "Mark Lula", Shkodër. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për veprat penale të "Vrasja me dashje" e "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta", thuhet në njoftimin e policisë. Sipas burimeve policore 33-vjeçari nuk ka bërë rezistencë ndërsa ndodhej

Vrau fqinjin se e akuzonte për vjedhje, kapet autori i dyshuar Alfred Pllumbaj

U largua nga vendngjarja me një makinë jeshile, ja si u lokalizuar 33-vjeçari



Viktima Prendush Fusha

pranë disa të afërme të tij në fshatin Bardhaj. Kur ka parë policinë i është bindur efektiveve duke u dorëzuar. Kujtojmë se ngjarja e rëndë ndodhi në derën e banesës së viktimës, ku mes autorit dhe Fushajt ka pasur një debat të fortë. Kjo pasi viktima e kish të akuzuar 33-vjeçarin se i kishte vjedhur një shumë parash.

VRASJA

Ngjarja e rëndë ndodhi rreth orës 19:15 të së hënës në lagjen "Mark Lula" në Shkodër ku Prendush Fusha u qëllua me thikë poshtë zemrës ndërsa në vetëm pak minuta humbi jetën në spital duke mos arritur që t'i bëjë ballë plagës së rëndë të mar-

rë në trupin e tij. 54-vjeçari Fusha është sulmuar në afërsi të banesës së tij. Menjëherë në vendngjarje ka shkuar një ambulancë e spitalit rajonal të Shkodrës duke bërë të mundur transportimin e 54-vjeçarit në urgjencën e spitalit. Në pak minuta mjekët kanë konfirmuar ndarjen nga jeta të Prendush Fusha duke qenë se goditjen me thikë e ka marrë në zemër dhe ka humbur sasi të konsiderueshme gjaku. Forcat e policisë menjëherë pas informacioneve të marra në rrugë operative në terren kanë arritur të bëjnë të mundur identifikimin e autorit të dyshuar, 33-vjeçarin Alfred Pllumbaj. Burimet policore bënë me

ARRESTIMI

"Lokalizohet, kapet dhe arrestohet autori i dyshuar i vrasjes së shtetasit Prendush Fusha, ndodhur mbrëmjen e së hënës rreth orës 19:15 në lagjen "Mark Lula". Pas një pune intensive të Forcave Operacionale në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, në bashkëpunim me FNSH Shkodër, u bë i mundur lokalizimi, kapja dhe arrestimi brenda 24 orëve, i shtetasit Alfred Pllumbaj, 33 vjeç, banues në lagjen "Mark Lula", Shkodër.

vjedhjes dhe se nuk ka asnjë lidhje me ngjarjen e ndodhur në banesën e Prendush Fushaj.

Policia duke mos pasur prova për autorësinë e vjedhjes e ka lënë të lirë 33-vjeçarin, pavarësisht akuzave të ngritura ndaj tij për vjedhje. Më pas mbrëmjen e së hënës Alfred Pllumbaj ka shkuar në banesën e 54-vjeçarit duke i kërkuar llogari në lidhje me padinë për vjedhje që ka bërë në adresë të tij. 33-vjeçari ia ka mohuar se është ai autor i vjedhjes, por nga ana tjetër Fusha nuk është bindur nga fjalët e tij. Biseda ka agravuar më shumë me tyre duke debatuar lidhur me ngjarjen. Të dy shtetasit e përfshirë në këtë debat kanë ngritur tonet aq sa i kanë dëgjuar edhe persona të tjerë që kanë qëlluar në afërsi. Në debat e sipër policia dyshon se shtetasi Alfred Pllumbaj ka nxjerrë një thikë që e kishte me vete dhe ka goditur poshtë zemrës 54-vjeçarin i cili mbeti i plagosur rëndë dhe më pas humbi jetën në spitalin rajonal të Shkodrës. Menjëherë pas ngjarjes autori është arratisur dhe policia u vntë ndjekje të tij. Pas një pune intensive uniformat blu arritën të lokalizojnë dhe të arrestojnë 33-vjeçarin Alfred Pllumbaj.

dije se ditët e fundit në banesën e viktimës është vjedhur një shumë e konsiderueshme parash. Pas kësaj ngjarje viktimja Prendush Fusha ka shkuar në policinë vendore të Shkodrës dhe ka bërë një padi duke përmendur si autor të mundshëm të vjedhjes pikërisht 33-vjeçarin Alfred Pllumbaj. Forcat e policisë kanë shoqëruar në ambientet e policisë 33-vjeçarin, por ai ka deklaruar për oficerët se nuk është autori i

Pa patentë dhe me drogë në makinë, arrestohet 27-vjeçari në Bulqizë

BULQIZË - Një 27-vjeçar ka rënë në prangat e policisë në Bulqizë pasi është kapur me një sasi lëndë narkotike kanabais sativa. Bëhet fjalë për Sajmir Durici, banues në Dushaj-Bulqizë. "Në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e trafikimit të lëndëve narkotike si dhe mbi bazën e informacioneve të marra në rrugë operative, se një shtetas po përgatitej të shiste lëndë narkotike në doza të vogla, nga efektivet e Sektorit për Krimit në bashkëpunim me shërbimet e Komisarariatit të Policisë Bulqizë, në hyrje të qytetit të Bulqizës kanë ngritur një pikë kontrolli ku kanë ndaluar një automjet me drejtues shtetasin Sajmir Durici, ku gjatë kontrollit të dokumentacionit rezultoi se drejtonte automjetin pa u pajisur me leje drejtimi. Gjithashtu, rezultoi se nën sediljet e pasme të automjetit kishte fshëhur një çantë ku brenda saj kishte një sasi lëndë e dyshuar narkotike, kanabais sativa. Nga informacionet e grumbulluara dyshohet se do ta shiste në doza të vogla. Lëndë narkotike u sekuestrua në cilësinë e provës material", thuhet në njoftimin e policisë.

Tentoi të vjedhë lekët e kishës së "Shënkollit" në Këlcyrë, arrestohet 43-vjeçari

PERMET - Policia ka mundur të parandalojë një vjedhje të kishës së "Shënkollit", në Këlcyrë duke bërë të mundur arrestimin e autorit. Nga specialistët për Hetimin e Krimit në Komisarariatit të Policisë Permet në vijim të punës për parandalimin e vjedhjeve bënë arrestimin në flagrancë të shtetasit Bujar Kalemi, 43 vjeç, banues në Zhapokikë, Memaliaj. Arrestimi i këtij shtetasi u bë pasi ka tentuar të vjedhë lekët në arkën e kishës së "Shënkollit" Këlcyrë ku është kapur në flagrancë nga shërbimet e policisë. Materialet në ngarkim të këtij shtetasi i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër për veprimet të mëtejshme.

Eric Siervo: S'ka të dhëna të sakta për përdoruesit, dhe cili është problemi real

Eksperti amerikan: Qeveria pranon rritjen e numrit të përdoruesve të drogës në Shqipëri

Qeveria shqiptare ka pranuar se përdorimi i drogave nga të rinjtë është në rritje. Për këtë arsye qeveria në bashkëpunim me ambasadën amerikane në Shqipëri kanë sjellë në vendin tonë organizatën ndërkombëtare CADCA, e cila merret me ngritjen e kapaciteteve për parandalimin e përdorimit të drogave tek të rinjtë. Eksperti amerikan i antidrogës Eric Siervo, njëkohësisht zëvendës-president i CADCA zhvilloi takimin e radhës në Shkodër duke thënë se në takimet e nivelit të lartë në Shqipëri pranohet rritja e numrit të përdoruesve të drogës. "Sigurisht që kemi



Eksperti amerikan, Eric Siervo

takuar zyrtarë të lartë të qeverisë shqiptare në Ministrinë e Brendshme, të Arsimit, zyrtar të lartë të Shëndetit Publik dhe përfaqësues të tjerë të qeverisë dhe në gjithë këto takime tona ata kanë mbështetur këtë ide apo këtë nevojë dhe ata kanë

thënë PO. Është e vërtetë se ka një perceptim dhe se është në rritje përdorimi i drogave. Vetëm në sajë të këtyre kontakteve kemi qenë në gjendje të identifikojmë ato komunitete më të përshatshme ku ne të fillonim të zbatonim projektet tona",

shprehjet Siervo. Eksperti i antidrogës thotë se në Shqipëri nuk ka të dhëna të sakta për përdoruesit e drogës dhe nuk dihet se cili është problemi real ndaj ngritja e kapaciteteve komunitare do të sjellë një ndryshim duke marrë të dhënat reale, por edhe duke ditur saktësisht problemet. "Çelësi i suksesit është parandalimi i përdorimit të drogës nga të rinjtë, duhet t'i parandalojmë brezat e ardhshëm, por edhe ata të sotshëm në përdorimin e drogës, deklaroi eksperti. Kjo kërkesë që ne të jemi në Shqipëri ka ardhur edhe nga ambasada

amerikane, por edhe nga vetë shteti shqiptar", thotë Siervo. Një pjesë e punës së koalicionit, vijon eksperti amerikan, do të jetë që edhe vetë banorët të kthehen në një farë shkencëtari social që edhe ata vetë të mbledhin informacion dhe të vëzhgojnë se cilat janë ato droga më problematike që përdoren, sepse nuk mund ta bësh me hamendësim se shqetësim është shembull kokaina. Ngritja e koalicionit në Shkodër nga CADCA do të bëhet në bashkëpunim me organizatën YWCA ndërsa puna sapo ka filluar. Edhe Shkodra mendohet si një qark me probleme dhe përdorues të shumtë të drogave të ndryshme kryesisht tek të rinjtë. Se. Ni.

U arrestua për llogari të drejtësisë shqiptare, shtyhet ekstradimi i biznesmenit

Kokaina në Durrës, Gjermania nis hetim ndaj Arbër Çekajt

Pronari i "Arbri Garden", dyshohet për aktivitet kriminal në vendet e BE

Ina Allkanjari

TIRANE

Rreth katër muaj pas arrestimit të Arbër Çekajt, personit të dyshuar për trafikimin e 613 kilogramëve kokainë kolumbiane në portin e Durrësit, Gjermania ende nuk e ekstradon atë drejt Shqipërisë. Ndërsa u arrestua për llogari të drejtësisë shqiptare, në maj të 2018, Arbër Çekaj ende ndodhet në Gjermani. Autoritetet gjermane kanë informuar prokurorinë shqiptare se kanë nisur hetimet për Çekajn, pasi kanë dyshime se ai është i përfshirë në aktivitet kriminal edhe në territorin e tyre. Ndërkohë nuk jepen shpjegime nëse biznesmeni, po hetohet nga gjermanët vetëm për episodin e trafikimit të sasisë rekord të drogës, apo edhe raste të tjera. Kjo për faktin se prokuroria e Krimeve të Rënda nuk është vënë në dijeni të asnjë të dhënë të grumbulluar nga homologët gjermanë. Hapja e hetimit ndaj Çekajt po vonon ekstradimin e tij ku sipas procedurës pas arrestimit të biznesmenit pala shqiptare paraqiti prova e fakte ku kërkonte që ai të ekstradohej pasi ka një urdhër arresti në mungesë si i dyshuar për trafik ndërkombëtar droge. Ndërkohë të vetmit që vijojnë të mbahen në qelitë e paraburgimit për trafikimin e drogës me vlerë 180 milionë euro, janë menaxheri i kompanisë, Donaldo Lushaj dhe shoferi i kamionit, Armand Pezaku. Prokuroria shqiptare ka dyshime se droga e kapur në magazinat e kompanisë 'Arbri Garden', do të trafikohej drejt vendeve të BE-së, ndër të edhe në Gjermani.

ARRESTIMI I ÇEKAJT

Rreth dy muaj pas kësaj se 613 kg kokainë arrestohet në Gjermani Arbër Çekaj, pronari i firmës 'Arbri Garden', i cili ishte shpallur në kërkim pasi kishte porositur kontejnerin me banane ku u gjetën 613 kg kokainë që vinte nga Kolumbia. Menjëherë pas operacionit policor i koduar 'Last Snow', ku u bë e mundur sekuestrimi i drogës, Çekaj u largua në gjermani dhe ndaj tij u lëshua një urdhër-arrest ndërkombëtar. Konkretisht Çekaj u kap në rrethinat e Dusseldorfit. Dyshohet se ai kishte ndryshuar identitetin nga Arbër Çekaj në Arbër Jansen, duke marrë mbemrin e bashkëshortes së tij me origjinë daneze.



Pronari i "Arbri Garden", Arbër Çekaj

Ai u gjet i fshehur në një banesë dykatëshe dhe gjatë momentit të arrestimit mësohet se nuk bëri rezistencë. Policia shqiptare ka bërë të ditur se arrestimi i tij u bë falë bashkëpunimit me agjencitë e huaja ligjzbatuese dhe konkretisht me atë gjermane, është bërë i mundur lokalizimi i tij. "Në kuadër të bashkëpunimit me agjencitë e huaja ligjzbatuese dhe konkretisht atë gjermane është bërë e mundur lokalizimi dhe arrestimi

i Arbër Çekajt. Ai është pronari i firmës 'Arbri Garden', ku u sekuestruan 613 kg kokainë në kuadër të operacionit "Last Snow". U shkëmbye informacion në kohë rekord midis Policisë së Shtetit dhe agjencive të tjera, si dhe me Prokurorinë e Krimeve të Rënda", sgaroi Policia e Shtetit në një njoftim për mediat. Kujtojmë se kapja dhe sekuestrimi i sasisë rekord prej 613 kg 350 gr lëndë narkotike e dyshuar kokainë, me vlerë tregu

mbi 180 milionë euro u bë e mundur si rezultat i operacionit policor të koduar "Last Snow". Hetimet dokumentuan se lëndë narkotike ishte nisur me kontenerin nga Kolumbia duke kaluar transit përmes Italisë, në Maltë e më pas me anije ka mbërritur në Portin e Durrësit në Shqipëri, më 19 shkurt të këtij viti. Sipas policisë, kokaina ishte e fshehur në kontenerin me dyshime të dyfishtë, të ngarkuar me banane.

E kaluara e errët e Arben Gjinit

Atentati ndaj 35-vjeçarit në Lezhë, ja pistat ku po heton policia

LEZHE - Prishja e pazareve të drogës është pista kryesore e hetimit për plagosjen e 35-vjeçarit Arben Gjini mbremjen e së hënës në Ishull Lezhë. Mësohet se 35-vjeçari është një emër i njohur për policinë. Burimet bëjnë me dije se Arben Gjini i ka shpëtuar edhe një atentati tjetër rreth 8 muaj më parë, kur sapo kishte dalë nga burgu. Gjini është ekstraduar nga Italia për në Shqipëri në vitin 2015, pasi ishte në kërkim për kultivim kanabisi. Ai ka bërë dy vite burg dhe më pas është liruar. Përkishtë pas lirimit nga burgu i është bërë atentati i parë, por fatmirësisht ka arritur të shpëtojë. Gjithashtu, mësohet se 35-vjeçari i janë vrarë edhe 3 vëllezër, njëri prej të cilëve në burg. Policia po heton në disa pista, por ajo më kryesorja është pista për prishjen e pazareve të drogës. Arben Gjini ka marrë një plumb në këmbë dhe në një në shpatull dhe ndodhet në Spitalin e Traumës. Ndërkohë ende nuk dihet se kush janë autorët e plagosjes, grupi hetimor po punon për zbardhjen e plotë të ngjarjes. Policia ka ngritur pika kontrolli me qëllim kapjen e autorëve.

Andi Spahia u qëllua me 4 plumba në trup

Tiranë, plagoset me armë zjarri në banesën e tij një 28-vjeçar

TIRANË - Një 28-vjeçar është plagosur me armë zjarri në banesën e tij në kryeqytet. Ngjarja mësohet të ketë ndodhur rreth orës 02:00, në rrugën "Tahsim Shehu", në zonën që mbulohet nga komisarati numër 4 në Tiranë. I plagosur me 4 plumba ka mbetur 28-vjeçari Andi Spahia, i cili është dërguar në spital dhe ndodhet nën kujdesin e mjekëve. Sipas burimeve mësohet se i riu ka marrë plumba në



këmbë dhe në shpinë. Por, nga ana tjetër, policia thotë se 28-vjeçari është plagosur me armë zjarri në këmbë, pa dhënë detaje se sa herë është qëlluar. "Më datë 28.08.2018, rreth orës

02:00, në rrugën "Tahsim Shehu", në banesë, është plagosur me armë zjarri në këmbë, në rrethana ende të paqarta, shtetasi A. S., rreth 28 vjeç, i cili ndodhet në spital jashtë rrezikut për jetën", thuhet në njoftimin e policisë. Grupi hetimor po punon për sqarimin e rrethanave të ngjarjes, por nuk ka ende një të dyshuar. Pritet dëshmia e 28-vjeçarit që mund të çojë në identifikimin e autorit.



Përfundon në pranga 18-vjeçari Arben Tabaku

Grabitën dyqanin e celularëve dhe plagosën punëtorin, arrestohet autori i dytë në Kuçovë

KUÇOVË - Policia e Kuçovës ka arrestuar ditën e djeshme autorin e dytë të dyshuar për grabitjen dhe plagosjen me thikë të një punëtori në një dyqan celularësh, ngjarje e ndodhur pak ditë më parë. Bëhet me dije se në pranga ka përfunduar 18-vjeçari Arben Tabaku, pasi na bashkëpunim me Klaudio Naska, i arrestuar më herët kanë plagosur dhe grabitur në dyqanin në pronësi të shtetasit G.D në lagjen "Llukan Prifti", Kuçovë. "Në vijim të ngjarjes së ndodhur në lagjen "Llukan Prifti", Kuçovë ku shtetasi Klaudio Naska (i arrestuar), në bashkëpunim me një shtetas tjetër të pa identifikuar pasi plagosën me thikë punëtorin e dyqanit, vodhën me dhunë 23 telefona celular dhe një Lap-Top, në dyqanin në pronësi të shtetasit G.D. Pas një pune të mirëorganizuar dhe falë bashkëpunimit me qytetarët u bë e mundur identifikimi dhe ndalimi i shtetasit Arben Tabaku, 18 vjeç, banues në lagjen "11 Shkurti", Kuçovë", thuhet në njoftimin e policisë.

Shitje me Ankand të dyte nga Studio Permbairmore L.D.C

"Trulli + ndërtesa", me nr pasurie 31/12, ZK 3428, vol 5, fq 3 me sipërfaqe totale trualli 1.837 m2 dhe sipërfaqe ndërtesë 260,6 m2 me adresë ish-hati Shtoj i Ri, Shkodër. Regjistruar ne Z.V.R.P.P Shkodër ne emer te Zako Spaso Akgjovë . Çmimi fillestar për shitje është 15.680.000 Leka. Data e shpalljes 26.07.2018 Data e zhvillimit 30.08.2018 deri ne oren 16.00 Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbairmore L.D.C me adresë Rruga "Myslym Shtyrj" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBAIRMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 3/438+2-53, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 36, FAQE 37, SIPERFAQE 103 M2. ZONA KADASTRALE 8380, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. ALBAN QEMAL BALA. ÇMIMI 8.700.000 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 24.09.2018 CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Trashëgimtarët që marrin këstin e parë dhe të dytë, dokumentet në drejtorinë e pagesave

Ish-të përndjekurit, në shtator nisin pagesa për 1000 përfitues

Financat: Nga 8 shtatori dorëzoni numrin e llogarisë dhe certifikatat

Ornela Manjani

Reth 1000 ish-të dënuar politikë apo familjarë të tyre do të marrin paratë e dëmshpërblimit në muajin shtator. Ministria e Financave njofton përfituesit që duke filluar nga data 8 shtator të dorëzojnë dokumentet që lu mungojnë në dosje për të marrë dëmshpërblimin. Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë jo parësore në radhët e ish-të përndjekurve politikë që mund të trajtohen me dëmshpërbim, por

që sipas këtij dikasteri duhet të dorëzojnë dokumentet. Ministria e Financave u kërkon përfituesve të kështit të parë të dorëzojnë në drejtorinë e pagesave numrin e llogarisë për të marrë dëmshpërblimin. Lista me përfituesit të cilët janë në radhë për këstin e tyre të parë, duhet të përditësojnë numrin e llogarisë bankare si dhe të dorëzojnë fotokopje të mjedit të identifikimit dhe çdo dokument tjetër që u mungon në dosje.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në



të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shumica e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit,

Emër/Mbiemër: apo në rast kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoem-

os që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në rast se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligi parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjykate që vërteton

vdekjen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet, kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse, dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave bën për të sqaruar trashëgimtarët e ish-të dënuarve që nuk kanë marrë ende dëmshpërblimin.

EMER FATJONA MELEQ DIANA AVNI MINTAS	ATESIA SIRAT RAMADAN MINTAS KADIU	MBIEMER DINAJ KALOSHI BEJKO	FLORINE HAJREDIN SAFIDJIE NURISH PLLUMB YLLI YMERY FATBARDHA XHEVDIT AFERDITA RUZHDI XHEVAIR ELVIS SELAMI GJON PJETER BARDHOCI PJETER SHYTI BARDHOCI SHEFQET METHOXHA METHOXHA METHOXHA METHOXHA DOKO COLLAHU HOXHA METHOXHA METHOXHA (KAPIDANI)	ABDYLL ABDYLL ABDYLL YMER RABIA FADIL FADIL FADIL SKENDER SKENDER SKENDER FERAZINI BARDHOCI PJETER SHYTI BARDHOCI SHEFQET METHOXHA METHOXHA METHOXHA DOKO COLLAHU HOXHA METHOXHA METHOXHA (KAPIDANI)	AHMATI AHMATI NDREU AHMATI RABIA BEJA GOXHARAJ GOME GUZA GUZA GUZA BARDHOCI METHOXHA METHOXHA METHOXHA DOKO COLLAHU HOXHA METHOXHA METHOXHA (KAPIDANI)	XHANE NEXHMUJE MEREME HANIFE ALLA FAIK HALIL SEIT HALIL XHELIL ISMVET DEMO BEJKUSH ALI MUSA SHEMO NEKI MUSA LIRI MUSA SOFIE MUSA FATIME QERIMMUSA MUHAMET LLUKAN ANDREA MIHAL SPIRO MARINA DUHUE ZENEL BERAM TOMORR BUJAR ARIFE DERMISHA SALI HAMET NEFERAT VANGJELJ(ESAT)HAMED FATIME KADENE RESMIJE RAHIM BEHARE REXHEP BAKI NEXHIP HAYSEN SKENDER FARUJE GANI RAMADAN(DAN) BUKURUJE HAZISRAMADAN(DAN) QAZIM HAZIRIE ABDI HAZIS FADIL ALI HANIFE LIZE LUIGJ PALINE TAHIR FEHIM LENE PAL DILE PRENUSH LENE PAL PAL BARDHOSH DILE BARDHOSH LAVER MEHMET ISMAIL DAUT HAMIT PETRINA MARK GEG HAVA NEZIR HATIXHE	HAMIT HAMIT HAMIT HAMIT DEMO SADIKAJ DEMO SADIKAJ ALI MUSA BRAHO BRAHO EMINI BENDO MUSA BRAHO MUSA SPIRO SPIRO CICOLLI SPIRO YMER YMER YMER YMER YMER YMER YMER HOXHA HOXHA HAMET HAMET HAMET BELLUL BELLUL BELLUL QERIM XHAFAJ NEXHIP NEXHIP RAMADAN(DAN) RAMADAN(DAN) DODA RAMADAN(DAN) DODA HAZIS HAZIS NDREU NEZHA NDREU MUKUA ALI GUINAJ LUIGJ MALELLARI NIKA NIKA NIKA PRENDI NDRECA ALI ALI ALI DAUTI DHIMITER LEKGEGAJ LITA ZENEL	BARDHI LALA BALLA SINA SADIKAJ SADIKAJ BRAHO AGOLLI BRAHO CICOLLI CICOLLI PROKO KUQI(MERLIKA) MERLIKA MERLIKA MERLIKA MERLIKA HOXHA THOMAI(HOXHA) DOLLANI ZENELI LARA KU XHYRA MERSINA SYLAJ XHAFAJ XHAFAJ CELIKA DODA DODA ALCANI NDOCAJ CULLAJ CULLAJ CULLAJ FRASHERI AHMATI
--	---	--------------------------------------	---	---	--	---	---	---

ELEZ ZENEL	LITA	NEVRIE	AHMET	KAPAJ	20714	Valentina	Gaci
SAHIT ZENEL	LITA	YLMIR AHMET	HAXHIRAJ		476700002	Vera	Shaqe
HYSNI ZENEL	LITA	FATIME	AHMET	CELAJ	14637	Violeta	Xhangolli
RRUZHDI	ZENEL	HARILLAOS	KLEARKO	GJIKURIA	13998	Zalide	Cala
MINE ZENEL	LITA	LLUKA	KLEARKO	GJIKURIA	13998	Zana	Kulloli
FILXHARUE	ZENEL	KATINA	KLEARKO	DUNI	13998	Zyra	Gjolena
ALI ZENEL	LITA	VASILIQI	KLEARKO	MUCO	20714	Çesk	Deda
MEXHIDE	DYLE	ZAHARULLA	KLEARKO	DUNI	20714	Margarita	Illa
MYFTAR	ISMAIL	VASIL KLEARKO	GJIKURIA		8833	Egriem	Saliqaj
HYSEN	ISMAIL	PRENE	LLESH	LLESHI	15591	Sanije	Hallii
HIKE ISMAIL	DISHA	DILA LLESH	LLESHI		3788	Anastas	Zeneli
NAZMIE	ISMAIL	ZEGJINE	KASEM	DIGNOZI	15591	Dituri	Shaqlli
ALLTANE	ISMAIL	XHAFERR	KASEM	HOXHA	9955	Fatmir	Zeneli
SHAJE	TUG	RUSTEM	KASEM	HOXHA	476700002	Shpetim	Çela
ALI SHEFQET	PIRI	SALIME	KASEM	MUCA	7607	Vera	Shaqe
DILAVER	HASAN	BESIM KASEM	HOXHA		7607	Jani	Pina
SHAQIBE	MURAT	IDRIZ KASEM	HOXHA		20121	Lavdije	Baçi
AGIM MURAT	GJOLEKA	DODE FRAN	ALIAJ		20121	Antoneta	muçi
FATO MURAT	BUSHI	TOINE FRAN	ALIAJ		20121	Banush	Pipiko
DRITA MURAT	PROKO	DRANE	FRAN	ALIAJ	19780	Etleva	Çobani
EMIN REFAT	AGOLLI	GJYSTE	FRAN	ALIAJ	19780	Frida	Lleshaj
FISE REFAT	HOXHA	DIELLA	FRAN	SMAJLIAJ	14953	Mirjeta	Sulejmani
ZARIFE	REFAT	LENA FRAN	LLOGORI		11519	Luftije	Zeneli
MYZAFER	REFAT	MIROSHI	KAMBER	ALIAJ	14953	Fecorr	Toshkezi
ENVER	REFAT	NURE KAMBER	LAMAJ		1404	Oshafi	Kapaj
BARDHYLE	REFAT	SPIRO KAMBER	MUCAJ		14667	Avdyll	Laze
FAHRIE	SALI	REFUE	KAMBER		18136	Denisa	Lazaj
HAVA SALI	BARDHII	MARIJE(MRI)	PREK	SHORAJ	9043	Djana	Zhiti
SELVIJE	SALI	ZELIHE	FETAH	GJELAJ	7036	fatime	Abedini
NURJUE	SALI	HAMITHALIT	SEFAJ	SEFAJ	9029	Ismail	Alla
TAHIR SALI	BORUFI	ALI HALIT	SEFAJ		7037	Qamil	Zekthi
KADIFE	SALI	PIRO HAXHI	BEDO		18264	Veis	Gjolena
IBRAHIM	HUNCI	DONIKA	HAXHI	BEDO	9029	Violeta	Baruti
FARJUE	HUNCI	SKENDER	HAXHI	BEDO	13467	Elze	Sinan
MIFTAR	HUNCI	DHURATA	HAXHI	BEDO	10297	Beqir	Shehu
BUKURJUE	HUNCI	SHOJPE	HAXHI	BEDO	11781	Fran	Gjoklaj
TUSHI	HUNCI	THELLENZE	HAXHI	BEDO	1030	Janulla	Gerbura
NDRIÇIM	HUNCI	JERINA	HAXHI	BEDO	18401	Lize	Jaku
PEJME ZEQIR	ALLA	ARBEN	HAXHI	BEDO	18401	Ndue	Jaku
ZARE ABDULLA	LAZRI				7814	Rudina	Hasani
NADIRE	DALIP				13467	Zojushe	Visha
ISMAIL	DALIP				5002	Bukurije	Sopaj
AHMET	DALIP				2276	Irfan	fezulla
NEKI DALIP	LAZRI				20380	Esat	Bilali
FADIL DALIP	LAZRI				18201	Gezim	bardhi
AVNI DALIP	LAZRI				18567	Kujtim	Brahushi
MYZEJENE	DALIP				13563	Lezbe	Ndreu
MEREME	IBRAHIM				20190	Qazim	Hoxha
RAMAZAN	ZENEL				8574	bate	hate
HYSEN	ZENEL				18201	Kristina	Sulanjaku
EVANTHI	VANGJIEL				21410	Aferdita	Aga
VASIL SPIRO	NIKOLLA				18201	Donika	Kule
ALEKS	SPIRO				21579	Engjellushe	Zhupa
KRISTINA	SPIRO				19640	Gezim	Mucaj
KOSTANDIN	SPIRO				20382	Marika	Elzei
LULASH	VAC				19280	Ramadan	Jaçelli
NIKE VAC	HILU				18201	Vasil	bardhi
SAIT SELIM	FUSHA				19676	Violeta	Isufaj
FIFE MEHO	FUSHA				19676	Vjollca	Tarka
MUHAMET	SAIT				15112	Zhuljeta	Tringoski
GJYLJUE	SAIT				7522	Astrit	Meta
ISUF SAIT	FUSHA				3511	barjam	Paja
ABAS MYNYR	SHEHU				10585	Gjon	Gjoka
HAMDI	MYNYR				9334	Ilyjije	Lujkaj
BEXHET	MYNYR				17522	Koci	Hetemaj
ENGJELLUSHE	MYNYR				18590	Meco	Marika
GJINOVEFA	MYNYR				10585	Buda	Zhulla
LEONIDHA	MYNYR				19525	Vrenozi	Preng
DRANDE	GJELOSH				18590	Vernozi	Qetsor
ZOJE DED	PROGNI				3511	Kadili	Sofi
LEZE DED	RAJA				18590	Kadili	Vangjel
MARI DED	PERPANAJ				3511	Veis	Zaim
NDREKE	DED				19525	Seilci	Adriatik
LULE DED	STAVRO				914	Seitlari	Agim
LINI DED	GURI				18428	Haxhiu	Asllan
MHILLI DED	GURI				18428	Kuke	Astrit
LUCE VATE	MUSAI				7977	Nuraj	Eleni
LORENC	VATE				21534	Cicaj	Engjellushe
KEL VATE	VATE				18428	Lilollari	Engle
LIZE(LEZE)	VATE				21534	Demiraj	Fatmir
GJON VATE	GJELOSHI(VATA)				19525	Kajo	Fatmir
JEORGJUCA	LLAZAR				19672	Jubica	Gjovallin
KRISTO	THEODHORI				18428	Skembi	Gezim
ALEKSANDER	THEODHORI				7977	Maliqati	Junie
VANGJIEL	THEODHORI				18428	Metalia (Paja)	Kujtim
KLEONIDHI	THEODHORI				15430	Çelaj	Luljeta
IFIGJENIA	THEODHORI				21531	Plau	Mimoza
KOSTANDO	THEODHORI				15430	Asllanaj	Nadire
KOCO MITRO	NIKOLLA				19640	Mavro	Petraq
JANI MITRO	NIKA				19640		gamie
AMALIA	MITRO				12355		Stefan
LEFTERIA	MITRO				18847		Urime
ZARJUE	IMER				7018		Veseli
BUKURIE	NJAZI				7018		Vitore
ZAHIDE	NJAZI				8949		serjan
NJAZI NJAZI	TONUZI				7525		Florika
SELMAN	TONUZI				13155		Hatixhe
RUKJUE	HYSEN				17160		Shpresa
AHMEDIE	SULEJMAN				1928		Kujtim
ZARJUE	IMER				500500001		Vitore
BUKURIE	NJAZI				17228		Mira
ZAHIDE	NJAZI				12895		hatije
NJAZI NJAZI	TONUZI				15355		Romina
SELMAN	HYSENAGOLLI				14154		Romina
SALO SHAHIN	MIRACI				11819		Nargis
OSMAN	ACIF				15173		beniamin
FATIME	ACIF				20279		Eda
HANUSHE	ACIF				14667		Manjola
MAZJUE	ACIF				16209		Vangjel
MAMUJUE	MESUT				11706		Qiani
HAXHI AHMET	HAXHIRAJ				6811		Qiani
SADUSHE	HAXHIRAJ				583		Abedin
SHABAN	AHMET				15430		Nadire
FADIL AHMET	HAXHIRAJ				2580		Gezim
HASAN	HAXHIRAJ				21357		Taras
XHEMAL	AHMET				9043		Ramije
HYSNIJE	AHMET				14193		Muhamed
	AHMET				15112		Petrit
	AHMET				19525		Lida
	AHMET				1928		Nermine

PROGRAMI I STUDIMIT INFERMIERI E PËRGJITHSHME: 2018-2019 RAUNDI I

Table with 3 columns: Rank, ID, and Score. Contains 260 entries of candidates for the nursing program.

Table with 3 columns: Nr, ID MATURANTI, and PIKET. Lists candidate names and their corresponding IDs and exam sessions.

Table with 3 columns: Rank, ID, and Score. Contains 155 entries of candidates for the nursing program.

Table with 3 columns: Rank, ID, and Score. Contains 230 entries of candidates for the nursing program.

(vijon në numrin e ditës së nesërme)

SUPER VERË, SUPER SMARTPHONE!

SUPER ÇMIM
20,500 LEKË

3GB
10 MINUTA
NDËRKOMBËTARE



GENERAL MOBILE GM 8

Versioni më i fundit i Android

Ekran 5.7 inch

13 MP kamera Selfie/kryesore

3 GB RAM

32 GB memorie e brendshme
(që zgjerohet deri në 128 GB)

Merr smartphone-in më të fundit General Mobile 8 me 3GB internet brenda muajit kalendarik, si edhe 10 minuta ndërkombëtare për 30 ditë, dhuratë për rimbushje nga 1,000 Lekë.

 www.albtelecom.al  [/albtelecom.al](https://www.facebook.com/albtelecom.al)  123

 **ALBtelecom**
...me ju të parët!

LUANA LAJMËRON QË DO PREZANTOJË 'BIG BROTHER VIP'

SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETË SHQIPTARË

E mërkurë 29Gusht 2018



**AULONA SHPËRTHEN
NDAJ KOMENTUESES**



**Liberta tensionohet: "Bëj
çfarë të më dojë qejfi"**

**BULEVARDI
POLITIK**



- Rama e takoi në 'Juventus Stadium', por Braçes i vjen fanella e Ronaldos me autograf
- Zbulohet arsyeja përse Princesha Kate Middleton ka një plagë në kokë
- Princi George regjistrohet në shkollën fillore, kurrikula mahnitëse
- Nis topin e parë, zv/kryeministri bëhet qesharak



Hapa të sigurt drejt një suksesi të madh, shqiptarja që i mahnitë të gjithë

KLAUDIA HAJDARI:

Ju tregoj përjetimet e mia si kandidate për komunën në Belgjikë

"Të rinjtë janë prioriteti im"

Hapa të sigurt drejt një suksesi të madh, shqiptarja që i mahnit të gjithë

KLAUDIA HAJDARI:

Ju tregoj përjetimet e mia si kandidate për komunën në Belgjikë

"Të rinjtë janë prioriteti im"

Egla Xhemali

Një personazh mjaft interesant vjen këtë herë në suplementin "Summer Pages" të "Gazeta shqiptare". Klaudia Hajdari na rrëfen për jetesën në Belgjikë, për postin e ambasadores në organizatën "YOUCA", përjetimet e familjes për këto hapa si dhe për objektivat që ka në plan të realizojë në Vilvoorde. Në Belgjikë ka mundësi të mira për t'u arsimuar dhe jo vetëm. Organizata në të cilën Klaudia është e angazhuar dhe ka rol drejtues i jep rëndësi të madhe të rinjve e bën që atyre t'u dëgohet zëri. Hajdari pohon se është fytyra e të rinjve belg dhe se u tregon atyre për projektin dhe për gjendjen në El Salvador. Ajo ndan me ne një nga momentet më të lumtura kur kryetari i Bashkisë së Vilvoordes i kishte shfaqur dëshirën për ta bërë pjesë të listës së kandidatëve për t'u bërë këshilltarrë e komunës duke qenë e vetmja nga moshatarët e saj që ishte aktive. Prindërit e kanë prituri shumë mirë këtë lajm dhe po e mbështesin atë. Klaudia kërkon që ta votojnë pasi ndryshimi sipas saj është rinia. Hajdari pohon se do japi maksimumin që në komunën e Vilvoorde të kenë një jetë sa më të mirë. Ne i urojmë që Klaudia të ketë sukses dhe të realizojë vepra sa më të mira!

Sa vjet keni në Belgjikë ?
Kam lindur në Bruksel më datë 19 shtator 2000.

Cili është stadi i arsimit tuaj?

Në shtator hyj në vitin e gjashtë ASO, që është stadi më i lartë i arsimit në Belgjikë.

Si është jetesa jashtë vendit tënd? (Favoret, vështirësitë..)

Në Belgjikë dëgjohej shumë zëri i rinisë dhe i japin shumë rëndësi opinionit të të rinjve. Ka mundësiira më të mira arsimit si dhe jetese, dhe mbi të gjitha in-

frastruktura është shumë e strukturuar.

Si erdhi dëshira apo propozimi për të qenë kandidate në zgjedhjet për këshill?

Unë isha 16 vjeçe kur u zgjodha si ambasadore e organizatës "YOUCA". Ajo është një organizatë që dëshiron t'i përforcojë të rinjtë në të gjithë botën. YOUCA (Youth for Change and Action) mendon që të rinjtë kanë po aq rëndësi sa të rriturit dhe mendon që edhe zëri i të rinjve duhet dëgjuar. Në vitin 2017 kemi pasur një projekt të madh në El Salvador (Amerika Latine) ku unë kam shkuar për ta njohur jo vetëm projektin, por edhe të rinjtë që jetojnë aty. Kam parë në ç'gjendje jetojnë familjet në El Salvador dhe kam parë se si organizatat në El Salvador ndihmojnë njerëzit që të mos jetojnë më në kushte të mjerueshme jetese. Ato i stimulojnë njerëzit që të



punojnë dhe të mbajnë jo vetëm veten, por edhe familjen. YOUCA organizon çdo vit një YOUCA Action Day. Atë ditë ka shumë të rinj që sh-

kojnë të punojnë për një ditë. Nxënësit që punojnë atë ditë shpërblehen me 50 dhe kjo shumë i shkon menjëherë organizatës. Në këtë mënyrë YOUCA ka mjaftueshëm fonde për t'i mbështetur organizatat salvadorane kështu që ata të kenë mjaftueshëm para për të organizuar aktivitete të ndryshme për të rinj për t'i mësuar se si mund të bëhesh (për shembull) një drejtor i suksesshëm. Si ambasadore e organizatës unë jam edhe fytyra e të gjithë të rinjve belg që punojnë atë ditë. Unë jam ajo që i tregon atyre për projektin dhe se si është gjendja në El Salvador. Kur u ktheva nga Amerika Latine kisha një konferencë



gazhuar. Nuk pranova menjëherë, sepse nuk e kisha menduar kurrë, por mendova që do ishte një eksperiencë e bukur dhe kjo është diçka shumë e madhe për dikë të moshës sime.

Si e pritit familja juaj këtë lajm?

Ishin shumë të lumtur për mua dhe deri tani më kanë dhënë mbështetje maksimale.

Çfarë mendon se duhet të përmirësohet në drejtim lokal?

Nëse fitoj dua të dëgjoj njëherë se ç'nevoja kanë të rinjtë në Vilvoorde, sepse rinia dhe Vilvoorde gjithmonë mbetet prioriteti im. Do bëja qmos që Vilvoorde të bëhet një qytet edhe më i sigurt dhe edhe më i këndshëm se ç'është tani.

Ku mendon të fokusohesh më shumë, në çfarë problematike?

Dua të fokusohem më tepër tek problematikat e të rinjve pasi edhe unë jam vetë e re dhe arrij të i kuptoj më mirë se të rriturit.

A të paragjokojnë njerëzit për moshën që ke?

Jo aspak, përkundrazi, janë një mbështetje e madhe, sepse besojnë të gjërat që do bëjmë ne, të rinjtë.

Çfarë do u kërkoje dhe premtroje zgjedhësve të tu?

Do t'u kërkoja që të besonin tek fuqia dhe idetë e të rinjve, sepse ne jemi ata që do bëjmë ndryshimin. Do t'u premtoja që do jap gjithmonë maksimumin tim, jo vetëm për të rinjtë, por që të gjithë në komunën e Vilvoorde të kenë një jetë sa më të mirë.



AULONA SHPËRTHEN NDAJ KOMENTUESSES

Aulona Musta është një nga moderatoret më të suksesshme. Së bashku me Fatmën, ato janë dyshja më ‘thumbuese’ e ekranit. Aulona njihet për karakterin e saj transparent dhe impulsiv, dhe jo pak herë postimet e saj në rrjetet sociale bëjnë bujë. Në postimin e fundit moderatorja shfaqet me bikini ndërkohë që pyet ndjekësit e saj se si janë, kodër apo fushë duke iu referuar linjave. Mirëpo një fansë ka lënë një koment ku i thotë Aulonës se është fushë nga trutë dhe i thotë se ‘ka ç’i duhen. Por Aulona se ka pritur mirë këtë koment dhe ia ka kthyer: “Fakti që je e vuajtur në jetë, nuk të jep të drejtën të bësh neperkën nëpër “Instagram”. Të paktën truri im fushë jep disa komanda të rëndësishme në fushën e komunikimit, siç janë shenjat e pikësimit, gjë që truri yt gjithë peshë nuk arrin ta bëjë dot”.




LUANA LAJMËRON QË DO PREZANTOJË ‘BIG BROTHER VIP’

Pas publikimit të projektit të fundit muzikor Luana Vjollca duket se po i shijon shumë këto ditë të nxehta vere. Si gjithmonë ajo di të tërheqë vëmendjen e të gjithëve dhe siç duket ka vendosur të mos ndalet së punuari pasi Luana ka treguar se ka disa plane të mëdha që patjetër do t’i realizojë. Sezonin e kaluar moderatorja u pa në drejtimin e emisionit “Shiko kush luan” në ekranin e ‘Top Channel’, që bëri shumë bujë. Mirëpo, duket se Luana këtë sezon të ri do të shfaqet në ekranin televiziv nën moderimin e një emisioni shumë herë më të madh. Duket se Luanës i është besuar moderimi i reality show-t ‘Big Brother Vip’, i cili do të vijë për herë të parë për publikun shqiptar. Edhe vet Luana ka postuar disa foto në profilin e saj në “Instagram”, ku tregon se ka nisur xhirimet për spotin televiziv.




REAGON SELDI PAS NDARJES ME MIMOZËN

Pak kohë më parë rrjeti u pushtua nga lajmi i fejesës së këngëtarëve Seldi Qalliu dhe Mimoza Shkodra. Madje, vetë çifti rrëfeu se në planet e afërta kishin edhe martesën. Por ç’ndodhi me ta? Kohët e fundit kishin rënë shumë në qetësi, nuk kishim dëgjuar as për ndonjë koncert së bashku, nuk pamë as foto nga pushimet e asgjë dhe të gjithë ishin të mendimit që Seldi dhe Mimoza Shkodra janë ndarë. Nuk kishte asnjë reagim nga ana e çiftit në fjalë, por ditën e djeshme Seldi ka reaguuar në profilin e tij në “Instagram”. I veshur me një bluzë të zezë, këngëitari pozon përpara kameras shumë serioz dhe me të vërtetë shihet shumë i pikëlluar. Ndoshta me fjalë nuk do reagojë, por kjo foto do të thotë shumë.



LIBERTA TENSIONOHET: “BËJ ÇFARË TË MË DOJË QEJFI”

Personat publikë zakonisht janë më të prekur ndaj kritikave. Ka nga ata që i marrin me sportivitet, por ka edhe nga ata që nuk ngurrojnë t’u kthejnë një përgjigje. Diçka të tilla ka bërë moderatorja e njohur Liberta Spahiu. Ajo ka publikuar një foto nga pushimet e saj në Dubai, por këtë herë bashkangjitur fotos ishte një mesazh paralajmërues për të gjithë ata që e ndjekin. E lodhur nga të tilla gjëra, Liberta ka shkruar: “Mirëmëngjesi njerëz. Çfarë bëtë?! Desha t’ju tregoj diçka, miqve, dashamirësve, atyre që m’i shohin fotot fshehurazi dhe atyre me profile false që ndonjëherë harrojnë fjalëkalimin e tyre, çdo koment me përmbajtje negative, fyese, apo frustruese do të zhduket nga faqja e dheut. Pse? Shumë thjesht! Është ‘Instagrami’ im dhe unë bëj çfarë të më dojë qejfi. Ditën e mirë. Faleminderit”.



Rama e takoi në 'Juventus Stadium', por Braçe i vjen fanella e Ronaldos me autograf

Kryeministri Edi Rama dhe deputeti i Partisë Socialiste, Erjon Braçe, janë të dy tifozë "te thekur" të Juventusit. Njeri bëri foto me yllin e skuadrës, Cristiano Ronaldo, gjatë vizitës së tij në Juventus Stadium me ftesë të Presidentit Andrea Agnelli, ndërsa tjetrit i ka ardhur fanella e portugezit në shtëpi. Në fundjavë, kreu i qeverisë postoi një foto pas takimit me 5 herë fituesin e Topit të Artë në ambientet e stadiumit. Dje deputeti socialist, Erion Braçe postoi një foto në 'Instagram', me një bluzë të Cristiano Ronaldo-s të firmosur. "Kur te vjen vëllai nga jashtë shteti dhe të sjell dhuratë Bardh e Zil," shkruan Braçe



Zbulohet arsyeja përse Princesha Kate Middleton ka një plagë në kokë



Në ditët e fundit, Kate Middleton ka shqetësuar jo pak popullin anglez, për shkak të disa fotove që tregojnë një shenjë të madhe dhe misterioze në anën e majtë të kokës, që duket të jetë një plagë. Një detaj jo i parëndësishëm, por deri më tani askush nuk e kishte vënë re. Më në fund, pas orëve misterit, siç shkruan "Mirror", Buckingham Palace ka folur për t'u dhënë fund thashethemeve: "Shenja lidhet me një operacion që Kate ka bërë në fëmijërinë e saj", dhe duke qenë se bëhet fjalë për një gjë private, zëdhënësi nuk ka dhënë më shumë detaje.

BULEVARDI POLITIK

Na merrni seriozisht! 🤔

Princi George regjistrohet në shkollën fillore, kurrikula mahnitëse



Shkollari George - Siç ndodh me të gjithë fëmijët nëpër botë, edhe Princit George do t'i duhet të arsimohet. Jeta e tij e re shkollore do të nisë pas pak javësh, me klasën e parë fillore. Prindërit e kanë regjistruar në "Thomas's Battersea", që gjendet në juglindje të Londrës, e ku duhet të paguash afro 20 mijë sterlina në vit. Kurrikula për princin është thujse gati, e në të përfshihen lëndë shkencore, historia e gjeografia, por edhe baleti. Princi është mësuar me uniformën e bardhë shkollore, pasi ka frekuentuar edhe ciklin parashkollor Montessori në Londër. George u lind më 22 korrik të 2013-s dhe tashmë i ka mbushur 5 vjeç.

Nis topin e parë, zv/kryeministri bëhet qesharak

Moses Ali, zv/presidenti i Ugandës, ishte protagonist i një skene qesharake në një ndeshje futbolli. Ai do të niste topin e parë në një ndeshje kampionati vendas, por kilogramët e tepërt e tradhtuan. Edhe truporjat e tij nuk e mbajtën dot të qeshurën...



PROTESTA

Demokracisë sonë të deformuar në këtë moment i vjen në ndihmë protesta “maratonë” e Teatrit, i vetmi për nga rëndësia kulturore që mund të ndihmojë në ringjalljen e frymës dhe shpirtit të demokracisë.

Teatri, si manifest në mbrojtje të qytetit dhe demokracisë

Nga Andi Tepelena*

Nisur nga debati për Teatrin që është “shndërruar” në temë politike të ditës, do të përpiqem të bëj një parantezë se çfarë po ndodh me Teatrin në raport me qytetin dhe demokracinë tonë.

Demokracia si proces që kërkon për zhvillimin e saj dhe ndërtimin funksional dialog me grupet e interesit, duket sikur të mos jetë devijuar, dhe në më të shumtën e rasteve ky dialog injorohet. Sa kaq duket t'i ketë shkaqet dhe në trashëgiminë që shoqëria jonë mbart nga sistemi totalitar. Sjelljet, tashmë të perceptueshme “*ictu oculi*” klienteliste të “Rilindjes”, kanë deformuar thelbin e demokracisë dhe kanë shtrembëruar parimet e ekonomisë së tregut. Ato kanë bërë që të dobësohet kohezioni social duke detyruar shqiptarët të braktisin vendlindjen. Kjo formë qeverisjeje duket të jetë bërë e huaj për shqiptarët dhe aspak garantuese e principeve demokratike mbi të cilat ajo duhet të udhëheqë bashkërendimin social! Nga ana tjetër, rrënim i trashëgimisë historike-kulturore, po merr trajtat e një degradimi kulturor.

Për fat të mirë, demokracisë sonë të deformuar në këtë moment i vjen në ndihmë protesta “maratonë” e Teatrit, i vetmi për nga rëndësia kulturore që mund të ndihmojë në ringjalljen e frymës dhe shpirtit të demokracisë. Teatri është treguesi më i qartë se si politika e keq-qeverisjes vendore është shndërruar në një “gangrenë betoni”, që po gërryen deri në “kockë” hapësirën publike. Mungesa e konsultimit me grupet e interesit dhe mungesa e transparencës së politikave urbane, dhe krijimi i zonave gri në qendër të Tiranës, të gatshme të kthehen në kulla, pasqyrë e spekulimit financiar do të sjellin pasojat e pariparueshme për qytetin, mjedisin dhe shëndetin psikofizik të banorëve të vet.

Tirana është qytet heterogjen, një produkt arkitektonik i disa proceseve historike, ku në të ndërthuren shumëllojshmëri stilesh, si ai otoman, monarkist, fashist, socio-realist i stampës sovjetike-kineze apo stili kafenonik i tranzicionit të stërzgjarur demokratik. Marrëzia pas kullave të larta po shpërfytyron dita-ditës, Tiranën. Qytetit të sotëm i mungon një fizionomi harmonike e përgjithshme. Ajo duket si koleksion i elementeve arkitekturorë që nuk lidhen dhe nuk komunikojnë me hapësirën ku shtrihen. Kryeqy-



teti ynë ka një përhapje gjeografike nga qendra në periferi me një numër “ekstravagant” shtëpish që kanë krijuar një hartë më vete të zonave informale, si pasojë e lëvizjeve demografike të pakontrolluara; e çfarë shtëpish! Në qendër, Tirana, tkurret nga kullat, e çfarë kullash! Arkitektura ka vdekur. Në periferi nga ndërtime “multiformëshme, që nëse do të kishin pasur pak stil Guadian, ndoshta do të kishin dhënë edhe një qasje ndryshe të perceptimit të tyre”. Po kush e zëvendëson Tiranën e sotme? Kush e di sa para do të duheshin për ta ndrequr këtë arkitekturë, të ndërthur si fole mizash me një larmishmëri të shëmtuar, karakter të paparashikueshëm që provokon ndjesi të dhunshme? Askush nuk është në gjendje t'i japë një

“Në qendër, Tirana, tkurret nga kullat, e çfarë kullash! Arkitektura ka vdekur”

përgjigje! Tirana e parë nga lart të ngjan me skena apokaliptike, ku betoni duket të mbizotërojë sovran, e shqepur dhe kaotike, kakofoni arkitekturorë e denjë për Lindjen e Mesme, post bombardimesh, apo Amerikën Latine, ku ndërmend të vinë favelas Braziliiane. Tirana, për syrin estetik ngjan si një krijesë arkitektonike e “djallit”, produkt i politikës dhe arkitektët e ferrit. Orientalizëm, pa orientalizim, pasi dhe ky i fundit mbart në vetvete shekuj trashëgimie artistike dhe kulturore - Kaos!

Tirana është qytet i mbipopulluar, me një dendësi prej 15 mijë ban-

orë për metër katror; apo katër herë më e lartë sesa norma e BE, aty ku nuk arrin të depërtojë drita e diellit mes pallateve, mungon ajri, sheshet për të rritur fëmijët dhe parqet për të bërë një shëtitje në muzgum stinor.

Tirana nuk është një kryeqytet atraktiv për kompanitë botërore të fuqishme, të cilat do të justifikonin ndërtimin e kullave si seli të aktivitetit të tyre ekonomik-financiar. Tirana është vetëm paraqja e call centerave, edhe për pak ndoshta. Tirana nuk ka nevojë për fuqi punëtore nga vendet azititike apo afrikane, pasi vet ajo, ka nivel pap-

unësie tashmë në nivele alarmante. Tirana ka një manaxhim politik jo demokratik, pavarësisht propagandës ngadhënjese apo retorikës aristoteliane të përpunuar “ad hoc”, qytetarët e saj nuk pyeten çfarë mendojnë për mënyrën sesi shpërndahen dhe shpenzohen taksat e tyre. Tiranasi ftohen vetëm një here në katër vjet për të votuar dhe, më pas, misioni i tyre bashkëqeverisës duket të tregtet sikur ëndrrat e një vizionari të Immanuel Kant.

Por çfarë duhet të bëjmë? Në këtë moment kritik për qytetin lipset një rikthim urgjent të njerëzorja, të dimensionit i humbur social- kulturor.

Nuk duhet të lejojmë kursesi të lëshojmë hapësira të hapura publike të zihen apo privatizohen me kulla shumëkatëshe, fantazma të vetvetes dhe dëshmi e babëzisë. Kullat zhvlehtësojnë cilësinë e jetës. Banorët e këtij qyteti një ditë do të turpërohen që e lejuan këtë marrëzi. Natyrisht ka vend për krijimin e hapësirave të lira urbane për plane arkitekturorë të guximshme që ndryshojnë nga modelet tradicionale në funksion dhe formë, por çdo qytet ka një përgjegjësi specifike. Nëse ky model aplikohet në New York, nuk mund të aplikohet në Tiranë. Nuk ka nevojë për zgjidhje globale, por zgjidhje të pjesshme në harmoni me mjedisin rrethues, ku lehtësisht kontakti njerëzor në rrugë dhe vetëdija kolektive të preken dhe marrin trajtën e një vizioni estetik të gjithëpranueshëm.

Nuk duhet të lejojmë dhe nuk mund të jemi bashkëfajtorë në shkatërrimin e identitetit në emër të gjoja zhvillimit modern, kur publikja shndërrohet në individualen, pasi ndryshe do ta humbim këtë qytet njëherë e përgjithmonë.

Nuk duam të jetojmë në një qytet të trishtuar, ku grimcat e betonit mbushin mushkëritë tona sikur të thithnin oksigjenin e prodhuar nga pisha a peme eukalipti, pa shërbime dhe struktura sociale, me një degradim dhe një korrupsion gjithnjë e më të dukshëm e që sa vjen e tolerohet, duke u shndërruar në një normalitet – anormal. Duhet të reagojmë, përpara një klase politike të paafte dhe cinike. Pas viteve 90', Tiranë duhet të kishte qenë krenari për të gjithë banorët e saj, anëmbanë, por, ende, nuk kemi parë një projekt të madh kulturor publik për qytetin, por çka na është ofruar është vetëm arkitekturë mizerabel dhe ndërtesa spekulative.

Marr shembull, sheshi (Opak) “Skënderbej” që duhet të paraqiste një vepër të madhe arkitekturorë

“Rezistenca fillon sot”, më 13 shtator votohet ligji për teatrin

Qeveria ka vendosur të mos tërhiqet dhe më 13 shtator duan të votojnë “ligjin special” në parlament. Mirë është ta kuptojnë ama se dhe ne nuk tërhiqemi. Rezistenca fillon që sot, në orën 19:30, në Sheshin e Teatrit. Prona publike do mbrohet, do apo nuk do Edi Rama!

Ka qenë ky mesazhi që qarkullonte kudo në rrjetet sociale dhe, pasi u shpërnda nga Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit pas 73 ditësh protestë të përnatshme në sheshin mes dy teatrove kombëtarë. Pasi e ka mbajtur në këmbë rezistencën edhe gjatë muajit gusht, çdo mbrëmje në orën 20:00 me



dokumentarë, filma, biseda që kanë rrokur nga hallet e përditshme të shqiptarëve te nismat e mbrapshta e të dyshimta të qeverisë së tyre, tanimë kur aksioni do të duhej të rimblidhte forcat e veta për një betejë ende më të fortë e të vendosur, fundgushti veçse rikuj-

ton ç'është lënë në mes kur korriku shkante e pushimet vinin. Nga 'sheshi i lirisë' ku disa ranë e disa u ngritën, ku qendra veçse ndërroi formë pa u cenuar, ata kërkojnë mbështetjen e qytetarëve për një kauzë që është më së pari e tyre, pra e qytetarëve.

“E vetmja frikë që mund të kenë është brenda jush...Mua s'më kanë bërë asgjë...As kanë pasur kurajën të më kërcënojnë...ose frikësojnë...Madje frikë kanë pushtetarët...Prandaj mos kini frikë shqiptarë...Ejani t'u tregojmë sa trimëri kemi në zemër” -shkruan aktori Neritan Liçaj. **f.n.**

ARTISTET E RINJ

bashkëkohore, një himn të gëzueshëm të novacionit, modës dhe dizajnit, por, trishtueshëm, u realizua monumenti më i madh i mediokritetit, kryeneçsisë dhe abuzimit propagandistik të pa harmonizuar dhe pakoordinuar me tërësinë e së bukurës dhe funksionale. Dhe "Sheshi" u shndërrua me bekimin ose heshtjen e arkitektëve tanë të ndriçuar "progresistë" në "mrekullinë e tetë".

Teatri, si bashkudhëtarë i projektit ndërtues trashëgimor, përbën, sot, barrikadën dhe qëndruesën ndaj politikave publike të pa-përgjegjshme. Qytetarët nuk duhet të asistojnë në homazhet funebër të Teatrit. T'i themi ndal kësaj neverie! Është momenti të ulërasim sikur në pikturën e Eduard Munch, ndaj përcudnimit që pasqyrohet në marrëdhëniet e arkitekturës me shtetin, politikën, dhe shoqërinë.

Ata që firmosin sot shembjen e Teatrit do të jenë përgjegjës para shoqërisë dhe historisë. Kjo djallëzi dhe shurdhëri politike në fund, paguan një çmim. Teatri duhet mbrojtur me çdo kusht nga tentakulat e oligarkëve të betonit. T'i themi ndal fenomenologjisë së marrëzisë, dhe mos të merremi me pasojat kur, nesër, të jetë tepër vonë, por t'ua ndalim zellin për shkatërrim, tan!

Duke cituar Christine Boyer, historiane e urbanistikës, që në librin e saj "Qyteti si kujtesë kolektive" thotë: janë mijëra ngjarje, kode dhe emocione, të cilat kanë ngelur të pathëna për ndonjë arsye apo tjetër, janë pikërisht këto grimca që plotësojnë fotografirinë dhe logjikën e qytetit, u bëjnë qytetarëve të ndalojnë me çdo çmim që edhe teatri të pësojë të njëjtin fat si objekte të tjera që shënojnë kujtesën tonë kolektive. Nuk duhet lejuar kurrsesi që të na imponojnë dhe të luajnë me hapësirat tona të bashkëveprimt me qytetin.

Po t'i referohemi Manifestit FREESPACE, të dy kuratoreve, arkitekteve irlandeze, Yvonne Farrell dhe Shelley McNamara, që u bë dhe pikë referimi e edicionit të fundit të Bienales së Arkitekturës në Veneçia, fokusi vihet pikërisht tek "dimensioni qytetar i arkitekturës, e quajtur politika e të gjitha arteve, gjua shprehëse e qytetarëve dhe një instrument i vetëqeverisjes", që i përgjigjet kërkesave cilësore nga ana e individëve dhe komunitetit, duke pranuar në këtë mënyrë arkitekturën si një instrument i shoqërisë për organizimin e hapësirës në të cilën jetohet. Teatri dhe territori i saj për qytetarët e Tiranës është në një farë mënyre "Akropolis" i Tiranës. Aty materializohet poezia dhe mendimi në nivelet më të larta. Ai është vendi qendror i Tiranës, shprehje e ndjenjës qytetare, vendi ku mund të ushrohet arti tradicional dhe bashkëkohor. Teatrit plotëson nevojën e komunikimit midis njerëzve. Mbrojtja e Teatrit bëhet element i harmonisë dhe frenues i apologjisë së parregullt të qendrës së Tiranës ku ndërtohen sipas parimit "çfarë të ha syri - ta kullëzon politika".

Duke e mbyllur me shprehjen e historianit dhe kuratorit të artit: Jaroslav Andil "artistët dhe intelektualët kanë qenë gjithnjë në ballë të proceseve demokratike, kundër ideologjive totalitare", në këtë moment tejet kritik për të ardhmen e qytetit dhe demokracisë, Teatri bëhet më shumë se kurrë manifest në mbrojtje të qytetit dhe demokracisë.

***Skena e Pavarur Kulturor**

"Who cares about art?"

"Art House" në edicionin e dytë të shkollës së artit

Edicioni i dytë i Art House School, në datat 20 gusht - 15 shtator, propozon edhe këtë vit një eksperiencë alternative shkollimi ku dijet nuk përcillen në mënyrë vertikale e hierarkike, por shkëmben në mënyrë rrethore mes pjesëmarrësve që do të ndajnë me njëri-tjetrin eksperiencat, punën dhe refleksionet e tyre. Art House School tenton të jetë një platformë informale e krijuese shkëmbimi mes artistëve, ku të bashkëjetojnë afria njerëzore me debatin kritik, gatishmëri miqësore me ndershmërinë intelektuale, mendimi ndryshe me nevojën për të vërtetën si horizont kërkimi. Artistët pjesëmarrës janë Lori Lako, Edson Luli, Marina Sula, Haveit, Doruntina Kastrati, Ergys Vela, Pleurad Xhafa. Krahas tyre një grup i ftuar kuratorësh, artistësh e drejtuesish institucionesh të rëndësishme ndërkombëtare: Helene Larsson - kuratore në Muzeun Historik të Suedisë në Stokholm, Johan Pousette - drejtor i iapsis, komiteti i granteve i artit suedez, një program ndërkombëtar për artistë vizualë dhe të dizajnit, Rein Wolfs - drejtor i Bundeskunsthalle Bonn, artistja Candice Breitz, Martin Engler - drejtues i departamentit të artit bashkëkohor në Stadel Museum Frankfurt, po njihen më nga afër me punët e artistëve të ftuar si dhe do të mbajnë biseda të hapura për publikun.

Duke vendosur shkëmbimin në qendër të marrëdhënies mes pjesëmarrësve Art House School, tematika e këtij viti është "Who cares about art?", e nënkuptuar më shumë si pyetje sesa si deklaratë. Pra ideja është të eksplorojmë kufijtë e artit dhe marrëdhëniet me atë që e rrethon, në një farë mënyre, në marrëdhënie me "jo artin".

E konceptuar si një platformë e lirë ku pjesëmarrësit i japin trajtë kësaj strukture, në të nuk mungojnë prezantimet e punëve të secilit, diskutimet mbi projektet apo intuicitat fillestare për punë që nuk kanë lindur akoma, lexime tekstesh e projektme filmash, refleksione e debate mbi argumente që do prezantohen nga të pranishmit, hapësirë për kërkim individual e punë në studio. Të jetuarit së bashku dhe kërkimi intelektual nuk do shihen si dy zona të ndara, por si procese ku format e mendimit, e të shprehurit dhe të jetuarit tentojnë t'i gërshtohen njëra-tjetrës.

KURATORËT

Në kuadër të takimeve që organizohen me të ftuarit për periudhën e Art House School, kuratorja Helene Larsson Pousette dhe Johan Pousette, drejtor i iapsis, komiteti i granteve i artit suedez për artistë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, qenë pjesë e shkollës me dy bise-



da që trajtuan aspekte të ndryshme të marrëdhënies së tyre me artin bashkëkohor.

Helene Larsson Pousette ka mbajtur takimin me titull "History Unfolds". Kuratore në Muzeun Historik të Suedisë në Stokholm i cili fokusohet në marrëdhëniet mes artit bashkëkohor dhe performancës, historisë dhe memories si dhe rolin e muzeve në historinë bashkëkohore. Më përpara ka qenë drejtuese e departamentit të aktiviteve kulturore në Institutin Suedez. Që nga viti 2009 e deri më 2012, ka qenë atash kuratore në ambasadën e Suedisë në Serbi ku ka punuar me diplomacinë publike dhe ndërtimin e marrëdhënies dhe shkëmbimeve

afatgjata mes artit e kulturës bashkëkohore. Aty ka marrë pjesë në shumë projekte si Muzeu i Zhvillimit në Serbi, programi rezidencial Create in Residence dhe ka themeluar grupin ETC që më vonë është shndërruar në Creative Mentorship program. Për shumë vite ka qenë kuratore e ekspozitave itinerante në Muzeun Historik të Suedisë duke ndërtuar marrëdhënie multidisiplinore që kombinojnë trashëgiminë kulturore me artin bashkëkohor. Helene ka qenë, gjithashtu, edhe anëtare bordi e ICOM-it suedez, ICEE - International Council of Exhibition Exchange dhe The Swedish Arts Grants Committee. Aktualisht është anëtare bordi e pro-

gramit Creative Mentorship dhe përfaqëson Suedinë në International Holocaust Remembrance Alliance (IHRA). Është lektore, autore e shumë artikujve dhe redaktore e publikimit This is not a Report - Cultural Exchange Sweden/Serbia 2009-2012 dhe The Museum as Forum and Actor (2010). Ka kryer studimet universitare në Etnologji dhe praktika e saj përqendrohet kryesisht në trajtimeve e tematikave më delikate të shoqërisë bashkëkohore.

Johan Pousette mbajti bisedën me titull "Trends in contemporary art in Sweden in International comparison". Drejtor i iapsis, komiteti i granteve i artit suedez, një program ndërkombëtar për artistë vizualë dhe të dizajnit; ai është koordinator për artin bashkëkohor në Riksställningar, agjencia suedeze e ekspozitave, e cila merret me zhvillimin dhe përhapjen e artit bashkëkohor në Suedi.

Ka punuar për shumë vite si drejtor, kurator dhe drejtues projektesh. Nga 2001-2007 ka qenë drejtor i Qendrës Artistike të Baltikut në Visby; ka një eksperiencë të gjerë në programe rezidenciale për artistë vizualë dhe të dizajnit, kombëtar dhe ndërkombëtar. Ka zhvilluar programe të reja rezidenciale në vendet nordike dhe baltike për Këshillin e Ministrave të Vendeve Nordike. Ka qenë anëtar bordi i Res Artis, një rrjet global rezidencash artistike dhe është anëtar i një grupi ndërkombëtar këshilltarësh për Trans Cultural Exchange në Boston, SHBA. Si kurator i pavarur ka bashkëkuruar Göteborg International Biennial for Contemporary Art, What a wonderful world (2009) dhe Salloni e 51-të të Teatrit (2010) në Beograd, së bashku me Celia Prado.



Opinioni *i* Ditës

Kosova e pavarur, si u bë përsëri çështje e hapur?

Nga Berat Buzhala

(vijon nga faqja 1)

... Amerikës dhe Kancelarja gjermane. Kështu, pak a shumë, raportuan mediat dhe. Kështu pak a shumë kanë raportuar mediat edhe në vitet '90, kohë kjo kur në Kosovë gjendeshin mijëra forca policore dhe ushtarake serbe.

Falënderimi për këtë i shkon presidentit Thaçi për talentin e treguar që një ndeshje të fituar, të verifikuar në Gjykatën Ndërkombëtare, ta rikthejë për t'u luajtur prapë. Pra, kjo nuk ishte një ndeshje e fituar vetëm në pjesën e parë dhe që serbët e rikthyen rezultatin në pjesën e dytë. Kjo ishte një ndeshje e përfunduar, mirëpo pas vërejtjeve të bëra nga ekipi fitues, pra Kosova, të mbështetur me duar të hapura edhe nga ekipi humbës, pra Serbia, komisioni disiplinor nuk kishte zgjidhje tjetër përveçse të vendoste për një ndeshje të re.

"Ui ar not problematik gajs..., ui traj tu du agriment..., jesss". Kjo fjalë - që ka mundësi të përfundojë në librat e historisë si njëra prej frazave më idiote - duhet të lexohet me aksent të Kazakistanit - If you know what i mean.

Pra, presidenti i Kosovës, duke e qortuar Bashkimin Evropian që të mos i konsiderojë Thaçin dhe Vuçiçin si djem problematikë, ose djem çapkënë, ai, tash e disa muaj me radhë, po e lut Perëndimin që t'ia lejojë atij ta arrijë marrëveshjen finale me Serbinë.

Në shqiptarët e Kosovës e kemi shpenzuar një shekull duke e kërcënuar Perëndimin që nuk bisedojmë me Serbinë pa prezencën e tyre, kurse tash befasisht Thaçi po e bën të kundërtën. Është dashuruar aq shumë në ish-ministrin e informatave të Milloshëviçit, aq afër janë, sa atë e thërrret në emër, sa kur bisedon me të e vë dorën në gojë që të tjerët të mos mund ta deshifrojnë atë bisedë konfidenciale. I pari simbolik i vendit, po e vë dorën në gojë që Gjermania dhe Britania e Madhe të mos e kuptojnë se çfarë po flet ai me Vuçiçin. Një gjë të tillë nuk e kemi parashikuar në asnjë variant. Vazhdimisht mbi premisën:

"Ui ar not problematik gajs..., ui traj tu du agriment..., jesss."
Pas gjithë këtyre zhvillimeve që po ndodhin për dhe rreth Kosovës, ministri sevдали i qeverisë serbe, kantautor folklorik Ivica Dačić, tash po u bën jehonë zhvillimeve të fundit politike. Derisa, Vuçiçi flet për mediat e huaja, Dačić i ushqen me informata mediat në Serbi.

"Serbia kurrë nuk ka pasur ambicie që ta rikthejë në gjirin e saj gjithë territorin e Kosovës, por vetëm disa pjesë të saj", ka



thënë ai.

Edhe për këtë një falënderim i veçantë shkon për presidentin Thaçi. Thaçi që dhjetë vjet bisedon me përfaqësuesit e Serbisë në Bruksel, për ta integruar veriun e vendit. Mirëpo, meqë nuk arriti ta integrojë në Kosovë, po arrin ta integrojë në Serbi. Nuk ka qenë aspak e lehtë. Me një zell të jashtëzakonshëm Thaçi arriti ta krijojë një momentum të përshtatshëm politik në Evropë, që kjo e fundit ta pranojë ndarjen e Kosovës. Vazhdimisht mbi premisën që:

"Ui ar not problematik gajs..., ui traj tu du agriment..., jesss."
Më fjalë të tjera, ne jemi dëshmitarë të asaj se si një person që gëzon mbështetje minimale popullore, më pak se 20 për qind, me një anglishtë shatra-patra arrin të bëhet sensacion ndërkombëtar. Diku sulmo mediat për "fejku njuz", diku ndonjë intervistë të dyshimtë të Ibrahim Rugovës, diku tjetër bëj një propagandë nacionaliste. Serbëve

thuaju që jeni të mirëseardhur në Gjakovë, sepse atje askush nuk mund t'ju ndalë, pastaj vra po në Gjakovë dhe thuaju nënave të veshura në të zeza tash e 20 vjet, që asnjë serb që ka kryer krime nuk mund të vijë në Gjakovë. Kjo është pak a shumë strategjia e tij.

Se ç'ka fshihet prapa gjithë kësaj shfaqje bizare teatrale, këtë askush nuk mund ta thotë me siguri. Dikush thotë se Thaçi po e bën këtë për të shpëtuar nga ndjekja e Tribunalit Special, kurse dikush tjetër thotë që këtë po e bën për ta fituar një çmim të mjerët Nobel. Mirëpo askush, përveç Kadri Veselit në momente të caktuara, nuk thotë që ai këtë po e bën se është në interes të Kosovës. Vazhdimisht mbi premisën:

"Ui ar not problematik gajs..., ui traj tu du agriment..., jesss."
Ajo që tashmë dihet në mënyrë të sigurt është se, me dëshirën tonë, deri në zgjidhjen "e statusit

final të Kosovës" Kosova do të konsiderohet, tashmë jo vetëm prej gjysmës së botës, por prej gjithë botës, pra edhe prej shteteve që na kanë njohur, si një çështje e hapur dhe që kërkon kompromis prej të dyja palëve. Deri në momentin që çështja e Kosovës të zgjidhet në mënyrë përfundimtare, askush prej nesh nuk mund të presë njohje të reja të vendit tonë në arenën ndërkombëtare, e as anëtarësim të Kosovës në organizata të ndryshme ndërkombëtare. Tash ne jemi, përsëri, një shoqëri që po e pret përfundimin e fatit të saj politik. Sigurisht kantautor i folkut serb, Ivica Dačić, do të kujdeset që këtë mesazh t'u ua shpërndajë të gjitha vendeve që na kanë njohur dhe atyre që nuk na kanë njohur. Ai do t'i tregojë gjithë botës, përmes ambasadave të Serbisë që, me dëshirën e Kosovës, është rihapur statusi final i saj.

"Ui ar not problematik gajs..., ui traj tu du agriment..., jesss."

HOROSKOPI

DASHI

Sot do të shpresoni shumë, ndjesi e cila do të jetë në rritje gjatë gjithë ditës. Nëse keni ndërmend të investoni diku, duhet të mendoni të gjitha detajet. Ka gjasa që të njihni dikë, me të cilin do të dashuroheni menjëherë. Nuk është dita e duhur për të udhëtuar.

DEMI

Duhet të risni sa më shpejt kujdesin ndaj shëndetit. Ka gjasa që të keni një të sëmurë, për shkak të disa investimeve që keni bërë disa kohë më parë. Të afërmit dhe miqtë do t'ju surprizojnë me disa dhuratë. Sot do të zbuloni se dashuria e partnerit/partneres suaj ndaj jush është plotësisht e vërtetë.

BINJAKET

Do të kaloni një ditë shumë të këndshme. Gjërat do të shkojnë ashtu sikur i keni dëshiruar. Partneri/partnerja juaj do t'ju kërkojë më shumë përkushtim. Përpiguni të mos mërziteni për disa çështje në punë. Bëni durim dhe mos veproni pa u matur.

GAFORJA

Zemërimi që do të ndjeni do t'i mërzisë shumë familjarët tuaj. Përpiguni ta largoni këtë ndjesi, para se t'ju 'dëgjë' edhe ju. Shmangni konfrontimet dhe mos tentoni të gjeni fajin tek të tjerët. Nuk parashikohet një ditë e këndshme as me partnerin/partneren tuaj pasi ai/ajo do t'ju lëndojë jo qëllimisht.

LUANI

Përpiguni të mos lodheni shumë, pasi kjo mund t'ju shkaktojë stres. Kundërshtarët tuaj në punë mund t'ju bëhen miq sot vetëm për shkak të një veprimi të mirë nga ana juaj. Çiftet e martuar do të kalojnë një ditë shumë të këndshme pranë njëri-tjetrit.

VIRGJERESHA

Gjatë ditë mund të nervozoheni për arsye të ndryshme, çfarë do të ndikojë negativisht në energjinë tuaj. Përpiguni të mendoni pozitivisht. Prindërit e kësaj shenje duhet t'i motivojnë fëmijët sipas pritshmërive të tyre, megjithatë mos prisni mrekulli teksa ai/ajo përpigjet.

PESHORJA

Sot është koha e duhur që t'i kushtoni vëmendje shëndetit. Bëni kujdes pasi ka gjasa që të shpenzoni më shumë se buxheti juaj. Gjatë pasdites mund të merrni një lajm shumë të mirë, i cili do të gëzojë të gjithë familjen.

AKREPI

Duhet të relaksoheni dhe të kryeni aktivitetet që iu pëlqejnë më shumë. Sot mund të fitoni shumë para, por për shkak të rritjes së shpenzimeve, do ta keni të vështirë të kurseni. Bëni kujdes me ato çfarë ndodhin rreth jush.

SHIGJETARI

Nëse kohët e fundit keni qenë të irrituar, duhet të kujtoni se më e mira e mundshme është të mendoni dhe të veproni me qetësi. Sa i përket anës romantike, do të jetë dita juaj me fat. Bëni kujdes nëse keni ndërmend të investoni diku.

BRICJAPI

Temperamenti juaj mund t'ju përballë me disa probleme. Përpiguni të kuptoni ndjenjat e partnerit/partneres suaj. Të tjerët do t'ju jenë mirënjohës nëse ndani me ta eksperiencat tuaja. Do të mërziteni nëse dini në përfundim dhe ndërmerrni hapa të panjohshëm.

UJORI

Përpiguni t'i shmangni udhëtimet e gjata pasi nuk jeni në kushte të duhura për të udhëtuar. Sëjpa juaj naive do t'ndikojë marrëmirë të zgjidhjen e disa problemeve familjare. Disa pikëpamje të ndryshme rreth çështjeve të caktuara mund të shkaktojnë debat me teje dhe partnerin/partnerin tuaj.

PESHQIT

Një vendim i nxituar mund t'ju shkaktojë probleme. Mendoni me qetësi para se të ndërmerrni vendime të rëndësishme. Eksploroni mundësitë e reja të investimit, të cilat do t'ju vijnë sot.

Partizani vijon të mbetet në merkato, teksa kur kanë mbetur dhe pak ditë në mbylljen e saj, drejtuesit e kuq kërkojnë të gjejnë elementët e duhur për të kompletuar skuadrën e Skënder Gegës, që në këto dy javë të para kampionatit ka shfaqur shumë probleme, sidomos në fazën sulmuese. Por pavarësisht sulmit, Gega kërkon përf forcime



Të kuqtë synojnë afrimin e një sulmuesi

Partizani zyrtarizon Uakilin dhe Feratin

në çdo repart, ndaj pardje në mbremje të kuqtë kanë zyrtarizuar mbrojtësin e majtë Alma Abo Uakili, 21-vjeçari i ardhur nga Shkëndija e Tetovës, që në këtë sezon ka vaujtur ri-

valitetin me Glendi Micin, ndaj ka pranuar ofertën e kuqe. Gjithashtu, dje me kryeqytetasit është bashkuar edhe një talent 18-vjeçar i ardhur po nga kampionati maqedon. Besnik

Ferati ka firmosur me Partizanin, ndërsa shikohet si një lojtar i perspektivës, teksa është pjesë e skuadrave zinxhir të përfaqësueses së Maqedonisë. Gjithsesi sulmi mbetet

thembra e Akilit për Partizanin. Sulmues i vetëm në ekip është Rubin Hebah, që ende nuk po gjen përshatjen e duhur në skuadër, ndërsa në këtë rol adaptohet edhe Gerhard Progni. Së fundmi është folur për një interesim të të kuqeve për Jurgen Gjasulën, por gjërat kanë mbetur në kuadrin e bisedimeve. Megjithatë, kur kanë mbetur dhe 3 ditë deri në mbylljen e merkatos, çdo gjë mund të ndodhë.

Një ditë pas presidentit të Kukësit edhe homologu i tij i Skënderbeut kap linjën e ashpër



Jeton Selimi

Takaj: Mbështes Gjicin, bojkotojmë kampionatin!

Dy nga klubet kryesore, duan rikthimin e policisë

Një ditë pas deklaratës së fortë të presidentit të Kukësit, Safet Gjici, për bojkot të kampionatit, nëse nuk kthehet Policia e Shtetit në stadium, ka ardhur edhe reagimi i presidentit të Skënderbeut, Ardjan Takaj. "Për ne që duam qetësinë dhe që të funksionojë futboli në Shqipëri, që të shkojë në rrugën normale, normalisht që do të kërkojmë edhe qetësinë dhe rendin nëpër stadione, sepse është shumë e rëndësishme për vazhdimësinë e kampionatit. Nëse investojmë shuma shumë të mëdha për futbollin se prishet gara për hir të disa njerëzve të përpërgjegjshëm, është shumë e rrezikshme për ne që merremi me këtë punë," thotë presidenti bardhekuq në faqen zyrtare të klubit, teksa më pas vijon duke mbështetur "kërcënimin" e kolegut të tij të Kukësit, Safet Gjici. "Prandaj jam dakord me atë që ka thënë Gjici dje dhe i bashkohem apelit të Gjicit dhe jam gati që nesër të bojkotohet kampionati, sepse nuk është vetëm Superiorja, por, sepse është edhe Kategoria e Parë dhe e Dytë dhe imagjinojeni se çfarë do të ndodhë sapo të nxehet gara, kur gara të jetë më e egër. Unë e di se sa i kanë kapacitetet të gjithë klubet shqiptare për ta përballuar me stjuardë dhe u bëj thirrje këtyre që rrinë e presin të bëhet çfarë të bëhet, që të



cohen sot sa nuk është vonë. Pasi unë di kapacitetin financiar të gjithë këtyre klubeve që janë pas nesh, nuk i kanë për të paguar dhe përballuar një kosto të tillë shumë të madhe, kosto për të përballuar ndeshje derbi, të mëdha e të nxehta të kampionatit shqiptar. Ka kosto të madhe dhe në fund asnjë nga këto kompani me stjuardë të kampionatit sh-

qiptar nuk mund ta përballojë dhe të marrë përsipër edhe riskun në situata që do të ketë kampionati".

Më pas Takaj arsyeton qëndrimin e tij për bllokimin e kampionatit. "E rekomandoj se e shoh që situata është shumë e nxehtë, ky vit do të ketë shumë pretendentë, shoh që ekipet janë përfuruar, kanë hyrë me seriozitet shumë të lartë

në garë, kanë investuar të gjithë. Por që të mbrojmë investimet duhet t'i mbrojmë sot, t'i mbrojmë sot që të respektohet gara, është shumë mirë për të gjithë që të jemi bashkë sot, është e papërbalueshme. Kur flet Skënderbeu e Kukësi që është e papërbalueshme, mendo këto klubet e tjera më të vogla për të cilat është shumë e papërbalueshme".

Në fund Ardjan Takaj kërkon rikthimin e forcave të rendit duke thënë se ata duhet të jenë prezentë në stadium deri kur tifozërit të ndërgjegjësohen. "Policia e Shtetit është në zbatim të ligjit dhe në rast se kthehet ligji të funksionojë, siç ka qenë më parë, atëherë do të kalojë në atë rrjedhë normale se nuk është momenti në Shqipëri për të hequr policinë nga stadiumet se duhen dhënë shenja vit pas vitit që situata qetësohet, njerëzit ndërgjegjësohen. Atëherë jemi gati edhe ne që të merren masa për të zbutur, për të larguar policinë nga stadiumet e ta bëjmë me stjuardë. Nuk e di se sa e dinë kuptimin e stjuardëve njerëzit, se nuk janë truproja apo forca speciale, janë njerëz të zakonshëm, në të gjithë botën janë njerëz të zakonshëm. Mund të ketë edhe invalidë, fëmijë që njohin rregulloren, që ndihmojnë njerëzit ku të ulen e mbajnë qetësinë në vendet perëndimore. Kurse këtu nëse stjuardët i quajnë njerëz të forcave speciale atëherë nuk e ditkam në çfarë do të thotë stjuard".

Murinjo shkarkohet nga Mançesteri dhe

Gjithçka është ende në ajër, sa i takon të ardhmes së Murinjës, por dhe Spaletit, pasi të dy trajnerët nuk kanë pasur fillim të mirë të sezonit... madje, kanë pasur një fillim për t'u harruar.

Mbrëmjen e së hënës, Mançester Junajtid u shkatërrua në shtëpi nga skuadra e Tottenhamit 0-3 dhe e stoli i Murinjës u lëkund fort. Që para fillimit të sezonit, Mou ishte favoriti nga të gjithë trajnerët në Angli për t'u shkarkuar. Mediet italiane kanë publikuar një hipotezë që nuk mendohej aspak, deri më sot... Murinjo do të rikthehet te Interi, pasi si tekniku portugez, ashtu dhe Spaletit, priten të shkarkohen nga stolat e tyre respektive.

E KËRKON REJNXHËRSI

Transferimi i Eros Grezdës drejt Rejnshers Gllasgo është drejt finalizimit dhe në Skoci po mbledhin ngado informacione për këtë lëvizje që pakush e kishte parashikuar të skuadra që drejtohet nga Stiven Xherard. Në mediat skoceze janë shpërndarë sot me shpejtësi fjalët e trajnerit të përfaqësueses shqiptare, Kristian Panuçi, për mesfushorin ku tregon edhe për interesimin që kishte pasur për të nga

Panuçi entuziazmon skocezët për Grezdën

klube të vendeve të tjera. "Eros është një pjesëtar i rëndësishëm i skuadrës. Ai është i shpejtë, një lojtar direkt dhe bën që në fushë të ndodhin gjëra. Mendoj se loja e tij është përmirësuar ndjeshëm qëkur firmosi me Osijek. Unë di që për të ka pasur shumë interes nga klube në Itali dhe në Turqi", janë fjalët e trajnerit. "Ai është në

lojtar i mirë teknikisht dhe mund të shënojë gola të rëndësishëm, si ai që shënoi në Turqi për ne. Ai është ende i ri dhe mund të përmirësohet. Eros është në lojtar i rëndësishëm për skuadrën dhe shumë popullor", ishin deklaratat e Panuçit që u shpërndanë në të gjitha mediat kryesore skoceze.

E ARRESTOI POLICIA


Pas fitores 3-0 në transfertën e "Old Trafford" kundër Mançester Junajtid, tekniku i Tottenham, Mauricio Poçetino u pyet për "çështjen" Loris, që u arrestua disa ditë më parë, pasi u kap nga policia britanike duke i dhënë makinës së tij kur ishte i pirë. Strategu argentinasi tha: "Jo, unë kurrë nuk e konsiderova t'i heq shiritin e kapitenit

Poçetino nuk i heq shiritin e kapitenit Lorisit

Lorisit. Ajo që ndodhi ishte një përvojë e keqe për të. Ai ndihet shumë keq. Hugo kërkoi falje për të gjithë, por jo vetëm tifozëve tanë, por dhe mua, klubit dhe shoqëve të skuadrës. Ai tregon keqardhje dhe kërkoi falje për të gjithë vendin, sepse kjo përgjegjësi është masive. Mendoj se ishte një mësim i

mirë për të gjithë, një mësim që do ta ndihmojë shumë. Ai po e dënon veten. Ai ndjehet aq keq, sepse e di se ai ka bërë një gabim të madh, por unë mendoj se ai është një njeri me karakter. Ne do të, natyrisht, ta mbështesim atë, por duke e ditur se nuk mund ta justifikojmë sigurisht", - përfundoi Poçetino.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Humanisti i Rotterdemit
6. Mund të jenë cigaresh.
12. Capirossi i MotoGP.
13. Është bixhoz
14. I vetmi në orar.
15. Para Diego në Kaliforni.
16. Fillojnë sefte.
17. Është makina për guidë.
21. Inicialet e Benigni-t.
23. Janë riparime.
25. Janë të brishtë.
27. Fillojnë largimin.
28. Ishin kambistë të dikurshëm.
29. Një motoskaq gare.
31. Kështu thirrej Marco Pantani.
32. Janë penjtë për moline.
33. Emër vajze.
35. Janë edhe ato të cirkut.
36. Nuk ka tradhtari.

37. Janë baballarët.
38. Fillojnë titrat.
39. Ai dhe ajo.
40. Mbledh basketë separatistë.
41. Fillojnë saldimin.
42. Gjysma e krahut.
45. Në krye të armatës.
46. Gjysmë krisme.
47. Jepet për hartim.

VERTIKAL

1. Paul që qe poet i famshëm.
2. Dennis i McLaren.
3. Këndohet në opera.
4. Gjysmë siklet.
5. Kufijtë e matjes.
6. I zhvillon kongresi.
7. Inicialet e Moravia-s
8. Janë kreerë bandash.
9. Të fundit në tender.
10. Fund shkurti.
11. Mund të jenë grosistë
13. Ka shirit magnetik një e tillë.
15. Ishin engjëjtë korit të lartë
17. Janë gjynahet
18. Bega komik.
19. Janë shemra.
20. Inicialet e Morricone-s.
22. Janë edhe ato fetare.
23. Një gjuajtës francez.
24. Gjika e Dora D'Istria-s.
26. Qytet grek.
29. Bëjnë katrorë me një kat.
30. Ishin ndjekësit e Antistenit.
32. Shkruhet i treti.
34. Një sulm... kardiak.
36. Ki Moon i OKB
40. Inicialet e Rohmer.
43. Robert Mitchum.
44. Dy asa.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Bëhet një me psonisje.
5. Një mund të jetë qeveritar
11. Maiden që këndojnë.
13. Një ushtarak është solemn.
15. Inicialet e Mann shkrimtar nobelist.
16. Teket pa kufij.
18. Mbetet në fund.
19. Një treshe në skenë.
21. Një mongol i Timurlengut
23. Një peshk i rëndë.
25. Tiriac ish-tenist
26. Kufizojnë një takim.
27. U hodhën në Tartar nga Zeusi
30. Fillojnë nazet
31. Kalimi në krye.
32. Ishte gruaja që i dha ujë nga pusi Jezusit.
34. Janë portet.
35. Dashi kur mungon ai
37. Javier, shefi i diplomacisë së BE
38. Kufizohet në kufij
39. Ente Civile Europeane.

VERTIKAL


40. Një birrë.
41. Mbetur në fund.
42. Ramazzotti këngëtar
43. Janë në modë.
44. Janë tek në shaka.
45. Është dite në mbledhje.
47. Një pjesë e kandidatëve.
49. Jessica Parker aktore.
50. Inicialet e Presley.
51. Akoma është ndryshe.
52. Janë brijët në skuadër.
53. Qendër fitimi
8. Inicialet e Turgeniev.
9. Ndërmarrje Industriale Tiranë.
10. Mund të lakohet.
12. Janë araknidet si vejshua e zezë.
14. Mund të jetë e lirë në port.
17. Një mjet lundrimi.
20. Shkroi Rinoceronti.
22. Ekstrema në ritëm.
24. Kalohen në gjumë.
28. Filmi i parë shqiptar.
29. Fillojnë takimet
31. Kufizojnë kënde.
32. Një depozitë driti.
33. Janë vendet e para.
34. Një parabolë e tenisist.
36. Është logari që qërohet.
37. Shteti me Khartum.
38. Janë kapot e bandave.
40. Një thirrje e dëshpëruar nga direku.
41. Lidhin brigje.
42. Një lidhëz
46. King Cole i muzikës.
48. Fillojnë ndeshjen.
49. Sapo fillojnë.
50. Mbetet në fund.




Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

3		5			2
		9	2		8
5			4		9
6	3		7	8	
				3	
	1	5	6	9	4
7			1	2	
			6		3
		2			

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	2	5	1	3	9	4	8	6
4	6	9	2	5	8	3	7	1
1	8	3	4	6	7	9	2	5
8	4	7	5	9	2	1	6	3
9	5	6	3	8	1	7	4	2
2	3	1	7	4	6	5	9	8
3	7	2	6	1	4	8	5	9
6	1	8	9	7	5	2	3	4
5	9	4	8	2	3	6	1	7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Dashuria është çështje fizike, martesë është çështje kimie.
- Sjellja e njeriut është pasqyrë, ku gjithsecili tregon fytyrën e vet.
- Nuk ka rëndësi se me cilën grua martohet dikush. Një ditë pas dasmës, kur të zgjohet, do të shohë se u martua me një tjetër.
- Koha e tregon njeriun e ndershëm, kurse të keqin e njeh për një ditë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

4	2		9	4	1	10		5	10			
2	F	7	8	6		15	3	6	10	3		
10	2		8	5	3		9	3	7	9		
5	K	1		2	3	11	3	4	7	5	8	4
1	A		2	8	11	1	12	8	11	3	13	8
		5	3	6	3	12	8	13	8		1	6
5			11	3	16	3	6		6	6	1	
1		7	4	3	13	7	3		6			
2	3		8		7	5	1	11	3	4		
7	6		4	1	4	3	13	7	4	3	6	
11	3	2		16	8	11		9	15	4		
7	4	8	6	8		8	16		8	3	10	

M	A	S	H	U	R	K	A		I	R	A	K
E	S	T	E	R	A		D	H	U	N	A	
I	T	E	A	T	E	R		M	I	N		
E	R	A		P	O	L	A	R		T	A	
K	E	L		P	O	L	E	M	I	K	A	T
L		P	O	L	I	G	A	M	I			
E	T	A		P	I	K	A	T		R	E	L
K	O	M	O		D	E	N		T	O	K	E
T	R	I		S	E	T	M		N	U	N	
I	T		T	U	T	U		I	T	I		D
K	A	D	E	T		K	O	S	H		L	E
E	T	I	K		S	E	K	S	E	R	E	T

Thënie të mënçura

- Para martesës, një vajzë duhet të bëjë dashuri me burrin për ta mbajtur atë. Pas martesës, duhet ta mbajë atë për të bërë dashuri.
- Martesa është një ceremoni në të cilën vendoset unaza në gishtin e zonjës dhe në hundën e zotërisë.
- Ka njerëz që sa më shumë të bëni për ta, aq më pak ata bëjnë për veten e tyre.
- Edhe në qoftë se ëndëroni sikur po më rreh, më mirë zgjuhu dhe më kërkto falje

